



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 142

2 nëntor

2012

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr. 95/2012 datë 11.10.2012	Për ratifikimin e kontratës për dhënien në përdorim, në formën e huapërdorjes, me çmimin 1 euro, të një pjese të truallit të ndërmarrjes së qymyrgurit Valias, Kamëz, me sipërfaqe të përgjithshme 87 587 m ² , lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “The American International School System - Albania” (AISS)	7905
Vendim i KM nr. 675, datë 3.10.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.....	7910
Vendim i KM nr. 676, datë 3.10.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 152, datë 29.2.2012 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë për shitjen e 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2””	7911
Vendim i KM nr. 677, datë 3.10.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 153, datë 29.2.2012 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë për shitjen e 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare “Hec Ulëz-Shkopet””	7938
Vendim i KM nr. 682, datë 26.9.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Shëngjin të qarkut të Lezhës	7964
Vendim i KM nr. 683, datë 26.9.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 249, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Dropull i Poshtëm të qarkut të Gjirokastrës”	7965

Vendim i KM nr. 684, datë 19.9.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qelëz të qarkut të Shkodrës	7966
Vendim i KM nr. 685, datë 3.10.2012	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Vëndreshë të qarkut të Beratit	7967
Vendim i KM nr. 686, datë 3.10.2012	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Leshnjë të qarkut të Beratit	7968
Vendim i KM nr. 687, datë 26.9.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike në Elbasan	7968

LIGJ
Nr. 95/2012

PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, NË FORMËN E HUAPËRDORJES, ME ÇMIMIN 1 EURO, TË NJË PJESE TË TRUALLIT TË NDËRMARRJES SË QYMYRGURIT VALIAS, KAMËZ, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 87 587 M², LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “THE AMERICAN INTERNATIONAL SCHOOL SYSTEM - ALBANIA” (AISS)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet kontrata për dhënie në përdorim, në formën e huapërdorjes, me çmimin 1 euro, të një pjese të truallit të Ndërmarrjes së Qymyrgurit Valias, Kamëz, me sipërfaqe të përgjithshme 87 587 (tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) m², lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “The American International School System - Albania” (AISS).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.10.2012

Shpallur me dekretin nr.7796, datë 18.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani

KONTRATË HUAPËRDORJEJE

Në Tiranë, sot më datë 24 të muajit shkurt të vitit 2012 (dy mijë e dymbëdhjetë), u paraqitën para meje, noterit M.Toro, palët kontraktuese, si më poshtë vijon:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përfaqësuar nga z.Nasip Naço, i biri i Qaniut, i datëlindjes 5.4.1961, me banim në Tiranë, me nr.ID____, Ministër, me cilësinë e Huadhënësit, dhe

Shoqëria “THE American International School System-Albania (AISS)”, sh.p.k., e themeluar në bazë të legjislacionit shqiptar, me NIPT: nr.L 01704030 G, datë 4.5.2010, me seli në Tiranë, rr. “Myslym Shyri”, kulla 10, ap.3, e përfaqësuar ligjërisht prej z.Sokol Bejleri, i biri i Gëzimit, i datëlindjes 10.2.1960, lindur në Shqipëri, banues në Nju Jork, SH.B.A. me nr.ID____, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë me cilësinë e Huamarrësit.



Palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë me kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

Deklarimet paraprahe

Në kuadrin e zhvillimit në fushën e edukimit parashkollor privat, çerdhe, kopshte, të aktivitetit të mësimdhënies në fushën e ciklit të ulët, në arsimin 9-vjeçar, të arsimit të mesëm të përgjithshëm e profesional, të arsimit të lartë dhe kualifikimet në gjuhë të huaja në Republikën e Shqipërisë, mbi bazën e prioriteteve që qeveria dhe shteti shqiptar i japin këtij zhvillimi, në fushën e arsimit, ka ndërmarrë një investim serioz për ndërtimin e një kampusi të plotë shkollor të të gjitha niveleve, në vlerën totale prej 40 000 000 \$ (dyzet milionë dollarë, USA).

Baza ligjore

- Dispozitat ligjore të Kodit Civil për huapërdorjen;

- Ligji për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Akti normativ nr.4, datë 9.7.2008 “Për privatizim dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.587, datë 10.8.2011 “Për dhënien në përdorim, në formën e huapërdorjes, pa kundërshtpërblim, të një pjese të truallit të ndërmarrjes së qymyrgurit Valias, Kamëz, me sipërfaqe të përgjithshme 87 587 m² shoqërisë “The American International School System-Albania (AISS)”, sh.p.k.

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj kontrate është dhënia në përdorim shoqërisë AISS sh.p.k. nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) të sipërfaqes prej 87 587 m², në administrim të ish-ndërmarrjes “Miniera e qymyrgurit” Valias, Kamëz, Tiranë, që do të përdoret si truall ndërtimi për ndërtimin e kampusit të plotë shkollor të të gjitha niveleve, sipas gentplanit, projektit dhe plan biznesit bashkëlidhur kësaj kontrate.

Ky kampus arsimor synon të ofrojë nivel të arsimit parashkollor, të mesëm dhe të lartë, të bazuar në modelin amerikan, të promovojë bashkëpunimin midis institucioneve arsimore amerikane dhe shqiptare, të përmirësojë statusin social dhe ekonomik të zonës ku operon, të krijojë mundësitë ekonomike për punësim të komunitetit vendor, të rrisi trajtimin profesional, si dhe mundësimin e shkollimit të studentëve të ardhshëm shqiptarë në universitetet amerikane.

Neni 2

Përshkrimi i pronës

2.1 Ky objekt ndodhet në rrethin Tiranë, bashkia Kamëz, Valias.

2.2 Objekti është trualli me sipërfaqe prej 87 587 m² e ish-ndërmarrjes “Miniera e qymyrgurit Valias” me të gjitha objektet mbi të, sipas planimetrisë bashkëngjitur kontratës.

Neni 3

Kohëzgjatja e kontratës

3.1 Kjo kontratë jepet me huapërdorje me shpërblim, me çmimin simbolik 1 (një) euro.

3.2 Afati i kësaj kontrate fillon ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët dhe ratifikimit të saj në Kuvendin e Shqipërisë dhe vazhdon për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Për realizimin e kësaj kontrate, palët marrin përsipër këto të drejta dhe detyrime:

4.1 Të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë

Shoqëria do të përdorë pronën, objekt i kësaj kontrate, brenda kuadrit ligjor të referuar në këtë kontratë. Ajo merr përsipër të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen e tokës së marrë në përdorim përgjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

4.2 Shoqëria AISS merr përsipër me shpenzimet e veta rregullimin, sistemimin e ambientit ku do të zbatohet projekti dhe për çdo kundërshtpërblim që i detyrohet shtetit shqiptar nga prishja e domosdoshme të objekteve ekzistuese, përballohet nga shoqëria.

4.3 Shoqëria AISS merr përsipër që, brenda 18 muajve nga marrja e lejes së ndërtimit, të përfundojë etapën e parë të ndërtimit, e cila përfshin ndërtimin e godinave dhe rikonstruktivimin e terrenit. Vlera e fazës së parë është 18 000 000 \$ (tetëmbëdhjetë milionë dollarë USA), sipas planbiznesit të paraqitur.

4.4 Shoqëria AISS merr përsipër që brenda 18 muajve të tjerë nga mbarimi i fazës së parë, të realizojë përfundimisht projektin e paraqitur dhe ta verë atë në efikasitet. Vlera totale e investimit do të jetë 40 000 000 \$ (dyzet milionë dollarë, USA).

4.5 Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë

4.5.1 Ministria garanton që toka, objekti i kësaj kontrate, është në pronësinë e saj dhe ia jep shoqërisë AISS në përdorim sipas afatit të përshkruar më sipër. Ministria garanton shoqërinë për gëzimin e qetë të pronës gjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe garanton gjithashtu, se toka objekt i kësaj kontrate, është e lirë nga çfarëdo lloj barre, detyrimi ose çdo lloj pengese mbi pronën dhe nuk është e përfshirë në asnjë konflikt gjyqësor.

4.5.2 Në raste mosmarrëveshjeje mbi tokën, objekt i kësaj kontrate, ndërmjet Ministrisë dhe personave të tretë, Ministria është e detyruar dhe merr përsipër zgjidhjen e tyre personalisht, pa e penguar shoqërinë në përdorimin e sendit dhe për të plotësuar qëllimin e tij. Ministria merr përsipër të dëmshpërblejë për dëmin që mund t'i shkaktohet shoqërisë nga pretendimet e palëve të treta ndaj pronësisë së tokës së dhënë në përdorim.

4.5.3 Ministria ka të drejtën ekskluzive për të monitoruar zbatimin e detyrimeve nga AISS që rrjedhin nga kjo kontratë. Monitorimi do të kryhet me autorizim me shkrim të lëshuar nga Ministri i Ekonomisë ose Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4.6 Shoqëria AISS do t'i paraqesë huadhënësit informacion periodik çdo 6 muaj për realizimin e investimeve, punësimit sipas parashikimeve të bëra në projekt dhe plane biznesi.

Neni 5

Përgjegjësitë e palëve

5.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

5.2 Për qëllimet e kësaj kontrate, me "Forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmytja, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për atë kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

5.3 Shoqëria AISS merr përsipër me shpenzimet e saj të kryejë të gjitha veprimet për rehabilitimin e sheshit të ndërtimit pas miratimit të lejes në KRRTSH.

5.4 METE (Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) ka detyrimin për të kryer monitorimin e zhvillimit të projektit sipas destinacionit. Shoqëria AISS është e detyruar të raportojë periodikisht pranë METE-s për hapat e zhvillimit të projektit.



5.5 Ministria nuk do të përgjigjet për dëmet e shkaktuara për shkak të rrethanave të forcës madhore.

Neni 6 **Zgjidhja e kontratës**

6.1.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të kësaj kontrate.

6.1.2 Prona e marrë në përdorim është dëmtuar nga forca madhore në mënyrë të tillë që është e pamundur për shoqërinë të qëndrojë dhe të vazhdojë aktivitetin e saj.

Forca madhore përfshin, pa kufizim çdo akt lufte (të deklaruar ose jo), invazioni, konflikti të armatosur ose veprim i armikut të huaj, bllokadë, trazirë, terrorizmi ose ushtrim i fuqisë ushtarake, çdo tërmet, përmytjeje, zjarr, stuhi ose fatkeqësi natyrore e kurdo që ajo të ndodhë, çdo ngjarje ose rrethana analoge me sa më sipër.

6.2 Ministria mund të zgjidhë kontratën para afatit nëse:

6.2.1 Shoqëria përdor token, objekt i kësaj marrëveshjeje, për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 1 të kësaj kontrate;

6.2.2 Shoqëria nuk realizon investimet e kreyra brenda afateve dhe sipas projektit të përcaktuar në këtë kontratë.

6.3 Shoqëria mund të zgjidhë kontratën e huapërdorjes para afatit të caktuar, nëse:

6.3.1 Shoqëria duhet të lërë territorin shqiptar nëse ka luftë civile ose trazira;

6.3.2 Prona e marrë në përdorim është dëmtuar nga forca madhore, në mënyrë të tillë që është e pamundur për shoqërinë të qëndrojë dhe të vazhdojë aktivitetin e saj.

6.3.3 Sendi i marrë në përdorim ka të meta të fshehta, të cilat ulin, në mënyrë të dukshme, vlerën e përdorimit të kontraktuar;

6.3.4 Falimenton ose vendos të mbyllë aktivitetin e saj;

Në çdo rast, shoqëria ka detyrimin të informojë me shkrim palën tjetër, 1 (një) muaj para zgjidhjes së kontratës.

Neni 7 **Njoftime**

7.1 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet mes palëve do të bëhen me shkrim dhe do të dërgohen me postë rekomandë, ose me anë të një shërbimi korrier, me fax ose dorazi, në adresat e mëposhtme:

Për Ministrinë: Ministria e Ekonomiksë, Tregtisë dhe Energjetikës

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1001 Tiranë

Tel: (04) 2234052

Fax: (04) 2234052

Për shoqërinë:

AISS (AMERICAN INTERNATIONAL SCHOOL SYSTEM)

Adresa: Ish-Miniera e Valiasit, Kamëz, Tiranë

Neni 8
Ligji i zbatueshëm

8.1 Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe bazën ligjore të lartëcituar. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve.

8.2 Nëse mosmarrëveshje të tilla nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, do t'i shtrohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9
Dispozita të fundit

9.1 Pjesë përbërëse e kësaj kontrate janë: Kodi Civil, ligji për arsimin e lartë, ligji nr. 9967, datë 24.7.2008, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 587, datë 10.8.2011.

9.2 Palët bien dakord që, me miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit, të përpilon anekskontratat teknike, të cilat kanë të bëjnë me detyrimet që rrjedhin nga miratimi i lejeve të ndërtimit.

9.3 Kjo kontratë, si dhe shtojcat e saj që mund të bëhen midis palëve, hartohet me vullnetin e tyre dhe në përputhje me dispozitat e parashikuara nga Kodi Civil, nenet 659 e vijues.

9.4 Ndryshimet ose shtesat e kësaj kontrate janë të vlefshme vetëm në rast se bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dyja palët.

9.5 Kjo kontratë, pas fismosjes nga palët, do të regjistrohen në ZRPP.

9.6 Pjesë integrale e kësaj kontrate do të jenë: projektideja, programi akademik, plani arkitektonik i objektit dhe planbiznesi.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi me miratimin e saj nga palët dhe ratifikimin e saj në Kuvendin e Shqipërisë.

PALËT KONTRAKTUESE

PËR MINISTRINË E EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
MINISTRI
Nasip Naço

PËR SHOQËRINË
AISS SHA
Sokol Bejleri



VENDIM

Nr. 675, datë 3.10.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 329, DATË 12.7.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E TENDERIT PËR ZGJEDHJEN E INVESTITORËVE STRATEGJIKË DHE PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË ZOTËRUARA NGA SHTETI NË SHOQËRITË TREGTARE TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë tekstin e vendimit, emërtimi “Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohet me emërtimin “Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”.

2. Pas pikës 7 të kreut III, shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:

“7/1. Në rastin e tenderit të hapur me një fazë, Këshilli i Ministrave në vendimin sipas pikës 1 të kreut I të këtij vendimi, mund të përcaktojë që përmbushja nga kandidatët e kriterëve në përputhje me pikën 3 të këtij kreu, të vlerësohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, së bashku me ofertat e paraqitura prej tyre, pa qenë e nevojshme shprehja paraprake e interesit nga ana e kandidatëve dhe ftesa e tyre në tender nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”.

3. Shkronja “a” e kreut IV, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) një garanci bankare për sigurimin e ofertës, në vlerën e përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave të përcaktuar në pikën 1 të kreut I të këtij vendimi, në favor të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”.

4. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 676, datë 3.10.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 152, DATË 29.2.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË
INVESTITORËVE STRATEGJIKË PËR SHITJEN E 100% TË AKSIONEVE TË
SHOQËRISË AKSIONARE “HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5 e 8 të ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a., “HEC Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., dhe përcaktimin e formës e të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca 1 bashkëlidhur dhe që përmendet në pikën 1 të vendimit nr. 152, datë 29.2.2012 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



SHTOJCA 1

PROCEDURAT E TENDERIT DHE KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E INVESTITORËVE STRATEGJIKË PËR PRIVATIZIMIN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË ZOTËRUARA NGA SHTETI, QË PËRBËN 100% TË KAPITALIT TË SHOQËRISË “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” SH.A

Procedurat dhe kriteret e këtij tenderi janë përgatitur në përputhje me nenin 3 dhe 8 të ligjit nr. 8306 datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., “Hec Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sh.a.” dhe përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr 329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

1. HYRJE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë “QSH” ka ndërmarrë një sërë iniciativash në sektorin e energjisë, përfshirë dhe procesin e liberalizimit dhe privatizimit të tregut të energjisë, si rrjedhojë e aderimit në Traktatin që themelon Komunitetin e Energjisë, nënshkruar më 25 tetor 2005 në Athinë.

Masat kryesore të ndërmarra nga QSH, për liberalizimin e tregut të energjisë, midis të tjerave janë:

- Shkëputja nga KESH e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST);
- Shkëputja nga KESH e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
- Vendosja e rregullave të reja liberalizuese për tregun e energjisë, duke miratuar Modelin e ri të Tregut të Energjisë (vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19 mars 2008 “Mbi miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë”) dhe rregullat e reja të tregut të energjisë (vendimi i Entit Rregullator ERE nr. 68, datë 23 qershor 2008);
- Privatizimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), i shkëputur nga KESH.

QSH planifikon të zhvillojë më tej strategjinë e nisur prej saj, duke tërhequr investime të mëtejshme të huaja në sektorin shqiptar të energjisë, dhe veçanërisht në projektet e prodhimit të energjisë hidrike.

QSH, nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “METE” së Republikës së Shqipërisë ose “Shitësi”, dëshiron të privatizojë 100% të kapitalit të shoqërisë aksionare “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” sh.a., në vijim “Shoqëria Objekt”, e cila ka selinë e regjistruar në: Vlorë, Mesopotam, Bistricë, Sarandë, Shqipëri, regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me numër unik identifikimi L17106501F.

Shoqëria objekt është e angazhuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë nga burime hidrike dhe të shitjes së energjisë elektrike. Privatizimi i shoqërisë objekt do të realizohet me anë të shitjes së njëqind për qind (100%) të aksioneve të kapitalit saj, të zotëruar nga METE, në vijim “Paketa aksionare”, në favor të investitorit strategjik të përzgjedhur sipas këtyre procedurave të tenderit, në vijim “Projekti”.

Me synimin për të tërhequr investitorët strategjikë optimalë, operimin dhe zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë objekt, QSH-ja ka vendosur të nisë procedurat e tenderit të hapur ndërkombëtar “Procesi i tenderimit”, për lidhjen e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, “Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve”, midis METE dhe investitorit strategjik të përzgjedhur sipas këtyre procedurave të tenderit.

METE dhe/ose QSH, sipas rastit, rezervojnë të drejtën që në çdo kohë të rishikojnë apo anulojnë procesin e tenderimit për shoqërinë objekt, ose të refuzojnë çfarëdo rekomandim të dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave ose të mos lidhin marrëveshje me asnjërin nga ofertuesit, pa asnjë kosto e pa asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve për METE dhe/ose QSH, apo çdo ministrie, për komisionin e vlerësimit të ofertave, ose ndonjë përfaqësues të tyre, apo çdo anëtar apo personi tjetër, edhe nëse ka pasur dëme apo shpenzime të kryera, si dhe të rishikojnë procedurat e tenderit dhe/ose udhëzimet për ofertuesit.

Gjatë periudhës së vlefshmërisë së ofertës, deri në ekzekutimin dhe mbylljen e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, asnjë ofertues nuk do të ketë asnjë të drejtë në lidhje me shoqërinë objekt, si rezultat i paraqitjes së një oferte dhe/ose pjesëmarrjes në procesin e tenderimit dhe as METE, as QSH nuk kanë asnjë detyrim të lidhin një marrëveshje shitblerje aksionesh.

2. NJOFTIMI PUBLIK

METE do të publikojë një njoftim për procesin e tenderimit sipas VKM nr.329 datë 12/07/1999 të ndryshuar. Afatet kohore për nisjen e publikimit do të miratohen nga METE së bashku me “Udhëzimet për Ofertuesit”. Publikimi i njoftimit për fillimin e procesit të tenderimit do të kryhet në përputhje me kriteret e vendimit të Këshillit të Ministrave



nr.329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

3. RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË TENDERIMIT

3.1 Ligji i zbatueshëm

Procesi i tenderimit do të kryhet dhe do të rregullohet duke zbatuar procedurat e tenderit të përcaktuara sipas këtij dokumenti, si dhe nga udhëzimet për ofertuesit (përfshirë shtojcat), të miratuara nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3.2 Tender ndërkombëtar

Procesi i tenderimit është një tender i hapur ndërkombëtar me një fazë. Procesi i identifikimit dhe i pranimi të investitorëve strategjikë bëhet në përputhje me këto Procedura të Tenderit dhe udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat), të miratuara nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3.3. Gjuha

Gjuha e procesit të tenderimit do të jetë gjuha angleze dhe gjuha shqipe. Propozimet teknike dhe financiare, të paraqitura nga ofertuesit, si dhe korrespondenca dhe dokumentet që i përkasin ofertës duhet të paraqiten në anglisht, me përjashtimin që çfarëdo informacioni të paraprintuar që mund të paraqitet nga ofertuesi në një gjuhë tjetër, por me kusht që pjesët e rëndësishme përkatëse, të jenë të shoqëruara me përkthimin në gjuhën angleze, vërtetuar në vendin e origjinës së ofertuesit.

3.4 Pranimi i kushteve të procesit të tenderimit

Paraqitja e një oferte nga një ofertues nënkupton njohjen dhe pranimin e plotë të të gjitha kushteve të përcaktuara në këto procedura tenderi dhe në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat e saj), si dhe të të gjitha përgjegjësi që rrjedhin në rast se shpallet si ofertuesi fitues (siç përcaktohet në paragrafin 9.5.1).

3.5 Përkufizimet

Sa herë që përdoren në këto procedura tenderi, përveçse nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar si më poshtë, bashkëlidhur, nëse një

term nuk është përkufizuar në këto procedura tenderi, atëherë termi do të ketë kuptimin e përcaktuar në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat), të cilat miratohen nga METE. Në rastet e konfliktit midis termave të përcaktuar në këtë dokument dhe të njëjtave terma të përshtatur ndryshe në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat), përveçse nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e përshtatur në këto procedura tenderi do të mbizotërojnë dhe do të zbatohen, gjithashtu, edhe në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat).

Përkufizimet janë:

“Afati i paraqitjes së ofertave” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 7.2.1.

“Autoritetet” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 5.4.

“Çmimi i ofruar” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.1.11.

“Kalendari i parashikuar” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 5.5.

“Konsorcium” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 4.1.

“Kryesues” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 4.1.

“Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“METE” ose **“Shitësi”** ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Njoftim për tërheqje” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 7.4.

“Ofertë” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 4.1.

“Oferta financiare” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.1.3.

“Oferta teknike” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.1.2.

“Ofertuesi fitues” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 9.5.1.

“Ofertuesit” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 4.1.

Investitori i Interesuar është investitori individual apo Konsorciumi, i interesuar për privatizimin e 100% the aksioneve të Shoqërisë Objekt. Kurdo që përdoren në këto procedura, termi Investitor i Interesuar do t'i referohet Konsorciumit në tërësi, siç është përcaktuar në paragrafin 4.1, përveç se kur dispozita i referohet në mënyrë posaçme individualit anëtarëve të Konsorciumit.

“Paketa aksionare” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Periudha e vlefshmërisë së ofertave” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.2.1.

“Përgjigje ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 5.2.

“Procedurat e tenderit”, procedurat për privatizimin e paketës së aksioneve të shoqërisë objekt.

“Procesi i tenderimit” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Projekti” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“QSH” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Raporti i vlerësimit” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 9.2.

“Sigurimi i ofertës” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.1.12.



Shpenzimet e ofertës” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 3.6.

“Shoqëria objekt” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Udhëzime për ofertuesit” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 2.

3.6 Kostot

Investitorët e Interesuar do të përballojnë të gjitha kostot në lidhje me kryerjen e verifikimeve (*due diligence*) të tyre dhe përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës, dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e tenderimit, “shpenzimet e ofertës” përfshirë pa kufizim, të gjitha kostot dhe shpenzimet në lidhje me përfshirjen e Investitorit të Interesuar në:

- Grumbullimin e të gjithë informacionit tjetër, përfshirë verifikimet (*due diligence*);
- Intervistat;
- Përgatitjen e përgjigjeve ndaj pyetjeve ose kërkesave për sqarim nga METE;
- Përgatitjen e kërkesave gjatë procesit të sqarimit; dhe
- Diskutimet për marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve.

METE nuk do të jetë përgjegjëse dhe nuk do të ketë detyrimin të paguajë asnjë shpenzim për ofertën të kujtdo Investitori të Interesuar, pavarësisht nga kryerja apo ndërprerja e procesit të tenderimit.

4. OFERTUESIT

4.1 Investitori Strategjik

Oferta të vlefshme do konsiderohen ofertat e Investitorëve të Interesuar, të cilët janë investor strategjikë, sipas përkufizimit vijues, që do të quhen “Ofertuesit”:

1. Të jenë themeluar (në përputhje me legjislacionin që i zbatohet themelimit të tyre) si person juridik, me personalitet ligjor të ndryshëm nga ai i ortakëve/aksionarëve të tij;
2. Të kenë aftësi paguese dhe të mos jenë në procese falimentimi apo në procedura likuidimi;
3. Të zotërojnë burime njerëzore, teknike, profesionale, eksperiencë organizative ne menaxhimin e kompanive të mëdha;
4. Të zotërojnë burime financiare që nga llogaritë financiare të vitit të fundit financiar, të jenë të paktën të barabarta me 25 milionë euro (ose ekuivalenti në një monedhë tjetër).

Forma dhe përmbajtja e dokumenteve që vërtetojnë përmbushjen e këtyre kritereve do të miratohen nga METE, së bashku me udhëzimet për ofertuesit. Vlerësimi i këtyre kritereve dhe lëshimi i ftesës për ofertë do të jetë në diskrecionin e plotë të METE-s.

Oferta mund të paraqitet nga një konsorciumit midis disa Investitorëve të Interesuar të veçantë, duke pasur parasysh që një kopje e nënshkruar e marrëveshjes së konsorciumit duhet t'i dorëzohet METE-s, së bashku me dokumentacionin përkatës (siç kërkohet në udhëzimet për ofertuesit) për secilin anëtar, në lidhje me kriteret e mësipërme.

Për qëllim të këtyre procedurave tenderimi “Konsorcium” do të përkufizohet një marrëveshje *jonit-venture*, konsorcium ose çdo lloj tjetër marrëveshjeje e ngjashme për bashkimin e përkohshëm të ndërmarrjeve, pavarësisht nga titulli apo cilësimi ligjor në bazë të legjislacionit të zbatueshëm në vendin e origjinës nga vjen ky bashkim, i cili ka si objekt pjesëmarrjen e përbashkët në procesin e tenderimit dhe paraqitjen e përbashkët të një oferte për shoqërinë objekt. Anëtarët e konsorciumit nuk do të lejohen të ndryshojnë kushtet e marrëveshjes së konsorciumit gjatë procesit të tenderimit, dhe më tej, sipas marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, pa miratimin paraprak me shkrim të METE-s, i cili do të jetë në diskrecionin e saj.

Marrëveshja e konsorciumit duhet të tregojë anëtarin i cili do të jetë “kryesues” i konsorciumit, i cili do të ketë shumicën e pjesëmarrjes në konsorcium, dhe të cilit do t'i adresohet METE për të gjitha qëllimet gjatë procesit të tenderimit. Njoftimet e METE-s ndaj kryesuesit, dhe përgjigjet e kryesuesit do të jenë të detyrueshme edhe për anëtarët e tjerë të konsorciumit.

Çfarëdo ndryshimi i kushteve të marrëveshjes së konsorciumit gjatë procesit të tenderimit, pa miratimin paraprak me shkrim nga ana e METE-s, do të shkaktojë skualifikimin e konsorciumit dhe të anëtarëve të tij.

Nëse Oferta është paraqitur si konsorcium, atëherë çdo anëtar i konsorciumit duhet të përmbushë të paktën kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij paragrafi 4.1, me kusht që konsorciumi në tërësi, duhet të përmbushë të gjitha kriteret nga 1 në 5 të këtij paragrafi 4.1.

Vetëm Investitorët e Interesuar që plotësojnë këto kritere do të paraqesin një “Ofertë” sipas paragrafëve 6 dhe 7.



Një Ofertë e paraqitur nga Investitorët e Interesuar që nuk përmbush kërkesat sipas paragrafit 4.1 do të skualifikohet.

4.2 Kufizimet

Çdo investitor mund të marrë pjesë në procesin e tenderimit vetëm si një Investitor i Interesuar i veçantë, ose si anëtar i një konsorciumi të vetëm dhe secili Investitor i Interesuar i veçantë apo Konsorcium, mund të paraqesë vetëm një ofertë (siç është përshkruar në paragrafin 6 dhe 7).

Një Investitor i Interesuar i veçantë do të konsiderohet si pjesëmarrës në procesin e tenderimit kur:

- a) Investitor i Interesuar i veçantë ka paraqitur një Ofertë; ose
- b) Investitor i Interesuar i veçantë është anëtar i një Konsorciumi i cili ka paraqitur një Ofertë;

5. DOKUMENTET E TENDERIT

5.1 Përmbajtja e dokumenteve të tenderit

Dokumentet e tenderit përfshijnë:

1. Ligjin nr. 8306 datë 14.3.1998 “Për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë”;
2. Ligjin nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a., “Hec Tiranë, Lanabregas” sh.a., dhe “Hec Bistrice 1 dhe Bistrice 2 sh.a.” dhe përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., dhe “Hec Bistrice 1 dhe Bistrice 2” sh.a.”;
3. Vendimin e Këshillit të Ministrave që miraton këto procedura tenderi;
4. Udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat) të miratuara me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
5. Memorandumi informativ (CV) për shoqërinë;
6. Ekstrakti regjistrimi tregtar për “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” sh.a.;
7. Akti i themelimit/statut i “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” sh.a.;
8. Bilanci dhe raporti i auditimit të “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” sh.a. për vitin 2011.

Një kopje e të gjitha dokumenteve të tenderit si më sipër do t’i jepet çdo Investitori të Interesuar që i kërkon ato. Investitor i Interesuar që ka nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti me METE mund të marrë akses në të dhënat konfidenciale të dhomës së të dhënave të Projektit.

Secili Investitor i Interesuar do të verifikojë nën përgjegjësinë e tij të gjitha udhëzimet, kushtet dhe kriteret, format, specifikimet dhe çdo informacion tjetër të përfshirë në këto procedura tenderi dhe në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat). Nëse Investitor i Interesuar:

- a) Nuk arrin të paraqesë të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar nga këto procedura tenderi dhe udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat); ose
- b) Paraqet një ofertë e cila nuk përputhet në thelb me kushtet dhe kriteret e këtyre procedurave të tenderit dhe të udhëzimeve për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat), atëherë këto veprime janë nën riskun e Investitor i Interesuar dhe komisioni i vlerësimit të ofertave mund të deklarojë ofertën në mospërputhje me këto procedura tenderi dhe udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat); dhe mund ta refuzojë atë.

5.2 Sqarime mbi dokumentet e tenderit

Një Investitor i Interesuar i cili kërkon ndonjë sqarim apo ndryshim të udhëzimeve për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat) mund të njoftojë METE-n me *e-mail* në adresën e përcaktuar udhëzimin për ofertuesit dhe një kopje të saj te konsulenti IFC albaniahpps@ifc.org. Në të njëjtën mënyrë, nëse një Investitor i Interesuar mendon që ndonjë parashikim i rëndësishëm i udhëzimeve për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat) është i papranueshëm, mund ta ngrejë këtë çështje në çdo kohë, përpara afatit për paraqitjen e ofertave, siç specifikohet në kalendarin e parashikuar (përcaktuar më poshtë në paragrafin 5.5) pa paragjykuar të drejtën e diskrecionalitetit të METE-s për ta pranuar ose jo këtë kërkesë për ndryshim.

Çdo kërkesë për sqarim apo ndryshim të udhëzimeve të ofertës (përfshirë dhe shtojcat) duhet të merret (në mënyrën e përshkruar në paragrafin 5.2) jo më vonë se në datën e përcaktuar në kalendarin e parashikuar. Kopjet elektronike të përgjigjeve (nëse ka), përfshirë dhe një shpjegim të çështjes, por jo identifikimin e burimit “Përgjigje ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin”, do të vihen në dispozicion nga METE (apo nga personi i autorizuar nga METE) në dhomën e të dhënave të Projektit. Nëse pyetje të ngjashme apo të përsëritura bëhen nga Investitor i Interesuar, këto pyetje mund të listohen si një e vetme dhe METE mund t’i përgjigjet kësaj pyetjeje vetëm një herë. Asnjë përgjigje dhe/ose informacion ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin e dhënë me gojë apo me shkrim do të jetë detyruese për palët. Vetëm marrëveshja e shitblerjes së aksioneve dhe shtojcat e saj, nëse është lidhur në mënyrë të rregullt, do të ketë forcën e ligjit dhe do të jetë detyruese për palët.



METE do të organizojë 1 (një) raund komentesh, në mënyrë që Investitor i Interesuar të kenë mundësinë që të paraqiten dhe të diskutojnë me METE-n në lidhje me komentet e tyre me shkrim mbi udhëzimet e ofertës, përfshirë dhe marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve.

5.3 Ndryshimet e udhëzimeve të ofertës (përfshirë dhe shtojcat)

Në çdo moment para afatit për paraqitjen e ofertave (siç përcaktohet në paragrafin 7.2) METE mundet që, për çdo arsye, qoftë me iniciativën e saj apo si përgjigje ndaj sqarimeve të kërkuara nga një Investitor i Interesuar, të ndryshojë udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat). Asnjë komunikim tjetër i çfarëdo lloji, përfshirë por pa u kufizuar, përgjigjet ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin, nuk do të ndryshojë udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat).

Ndryshimet do të vihen në dispozicion nga METE (apo nga personi i autorizuar nga METE) në dhomën e të dhënave të Projektit.

5.4 Informacioni i dhënë nga autoritetet/verifikimet e ofertuesit

Secili Investitor i Interesuar është i vetmi përgjegjës për kryerjen e kërkimeve të pavarura, verifikimeve (*due diligence*) dhe çdo punë apo hetimi dhe për marrjen e çdo këshillimi tjetër të pavarur, me shpenzimet e tij, për përgatitjen e ofertës së tij dhe negocimit dhe përfundimit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve.

Asnjë përfaqësim apo garanci, e shprehur ose e nënkuptuar, nuk jepet dhe nuk do të ketë asnjë përgjegjësi të asnjë lloji për METE-n, stafin e saj apo agentët e saj “Autoritetet” apo këshilluesit e tyre, punëmarrësit, konsulentët apo agentët, për plotësinë apo saktësinë e çdo informacioni të përfshirë në dokumentet e ofertës ose në përgjigjen ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin, ose informacioni tjetër të dhënë gjatë procesit të tenderimit apo gjatë negociatave për marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve. Autoritetet dhe këshilluesit e tyre, punëmarrësit, konsulentët dhe agentët nuk do të jenë përgjegjës ndaj asnjë personi apo shoqërie si rezultat i përdorimit të ndonjë informacioni të përfshirë në dokumentet e tenderimit, në përgjigjet ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin apo dhënë gjatë procesit të tenderimit ose gjatë negociatave për përfundimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve.

Investitori i Interesuar nuk do të mbështeten mbi asnjë deklaram të bërë me gojë nga “Autoritetet”, këshilluesit, punëmarrësit, konsulentët dhe agentët e tyre.

Të gjithë Investitorët e Interesuar, para se të paraqesin ofertat e tyre, duhet të kontrollojnë të gjitha kriteret për përputhshmërinë me legjislacionin për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe kriteret e tjera të cilat i zbatohen shoqërive tregtare të cilat dëshirojnë të ushtrojnë veprimtari tregtare në Shqipëri.

Investitorët e Interesuar janë përgjegjës të vetëm për të gjitha çështjet në lidhje me aftësinë e tyre ligjore për të operuar në juridiksionin nën të cilin zhvillohet procesi i tenderimit.

Çdo informacion i dhënë nga “Autoritetet” gjatë zhvillimit të verifikimeve, do të jetë objekt i marrëveshjes së konfidencialitetit të nënshkruar nga të gjithë Investitorët e Interesuar.

5.5 Afatet kohore

Në këto procedura tenderi një ditë pune zyrtare, përveçse nëse është parashikuar ndryshe në dokumentet standarde të tenderit, do të jetë një nga ditët e javës, përjashtuar të shtunat dhe të dielat dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

Një kalendar i parashikuar për procesin e tenderimit është përfshirë në udhëzimet për ofertuesit “Kalendar i parashikuar”.

METE mundet që në diskrecionin e saj dhe pa njoftim paraprak ndaj Investitorëve të Interesuar, të ndryshojë kalendarin e parashikuar dhe të njoftojë Investitorët e Interesuar mbi këtë ndryshim, nëpërmjet një njoftimi në dhomën e të dhënave të Projektit.

Investitorët e Interesuar nuk do të mbështeten në asnjë mënyrë në kalendarin e parashikuar dhe METE nuk do të ketë asnjë përgjegjësi si pasojë e ndryshimeve të kalendarit të parashikuar.

6. OFERTAT: PËRGATITJA

6.1 Përgatitja e ofertave

6.1.1 Dokumentet përbërëse të ofertës

Kur paraqitet një ofertë në përputhje me paragrafin 7, secili Investitor i Interesuar mund të paraqesë një ofertë në lidhje me “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” sh.a.

Çdo e dhënë e rreme do të konsiderohet si e mjaftueshme për skualifikimin e Investitorit të Interesuar dhe çdo zbulim që Investitori i



Interesuar ka paraqitur informacion të rremë ose informacion të mbajtur të fshehur në ofertën e tij do të konsiderohet si shkak për zgjidhjen e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve.

Investitorët e Interesuar duhet të përdorin vetëm dokumentet standarde të procesit të tenderimit, pa bërë asnjë ndryshim të kushteve të tyre. Asnjë shënim mbi formatet e miratuara, përfshirë dhe ofertat teknike dhe financiare nuk do të pranohet. Ofertat e kushtëzuara nuk pranohen.

Çdo ofertë e paraqitur si më sipër, duhet të përbëhet nga dokumentet e mëposhtme:

6.1.2 Oferta teknike

Propozimi teknik, i përbërë nga dokumentet e mëposhtme, së bashku "Oferta teknike":

- a) Dokumentacioni i Kualifikimit të Ofertuesit sipas kërkesave të paragrafit 6.1.4;
- b) Formulari i aplikimit të ofertës sipas kërkesave të paragrafit 6.1.5;
- c) drafti final i marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, me secilën faqe të sigluar nga Investitori i Interesuar;
- d) Prokurë përfaqësimi me formën dhe përmbajtjen e kërkuar sipas paragrafit 6.1.6;
- e) Konfirmimi i kushteve teknike minimale sipas kërkesave të paragrafit 6.1.7;
- f) Konfirmimi i kushteve minimale të punësimit, sipas kërkesave të paragrafit 6.1.8;
- g) Deklarata e konfliktit të interesit sipas kërkesave të paragrafit 6.1.9;
- h) Deklarata e komisioneve dhe shpërblimeve sipas kërkesave të paragrafit 6.1.10;

6.1.3 Oferta financiare

Propozimi financiar, i përbërë nga dokumentet e mëposhtme, së bashku "oferta financiare":

- a) Formulari i ofertës financiare, sipas kërkesave të paragrafit 6.1.110 më poshtë;
- b) Sigurimi i ofertës, me formën dhe përmbajtjen e kërkuar sipas paragrafit 6.1.12;

6.1.4 Dokumentacioni i Kualifikimit të Ofertuesit

Secili Investitor i Interesuar që paraqet një ofertë (individualisht apo si konsorcium) do të paraqesë dokumentet vijues:

- a) certifikatë origjinale e regjistrimi ose ekstrakt i regjistrimit tregtar për Investitorin e Interesuar (apo për secilin anëtar të konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium), e cila tregon statusin e regjistrimit si person juridik me personalitet të ndarë nga ortakët/aksionarët e tij;
- b) certifikatë origjinale e lëshuar nga gjykata, regjistri tregtar ose autoritet tjetër në juridiksionin përkatës, e cila tregon se Investitori i Interesuar (apo secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) nuk ka deklaruar faliment ose nuk është i përfshirë në procedura likuidimi;
- c) pasqyrat financiare të audituara/paaudituar të vitit të fundit financiar të Investitorit të Interesuar (apo për secilin anëtar të konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium);
- d) Curriculum Vitae e Investitorit të Interesuar (apo për secilin anëtar të konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) me informacion mbi eksperiencën teknike dhe profesionale;
- e) Origjinal i marrëveshjes së konsorciumit mes Investitorëve të Interesuar, nëse oferta paraqitet si Konsorcium;

Të gjitha dokumentet e mësipërme duhet të jenë në gjuhën angleze, ose të shoqëruara me përkthimin në gjuhën angleze, të certifikuar në vendin e themelimit të kandidatit (ose anëtarëve të konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium). Dokumentet e përshkruara në pikën 1 dhe 2 më sipër duhet të jenë lëshuar jo më parë se 30 ditë kalendarike nga data e fundit e afatit për paraqitjen e ofertave, dhe duhet të mbajnë vulën e Apostilës në përputhje me Konventën e Hagës mbi Heqjen e Kërkesave për Legalizimin e Dokumenteve të Huaja Publike (ose të jenë legalizuar nga autoritetet përkatëse diplomatike Shqiptare).

6.1.5 Formulari i aplikimit të ofertës

Forma dhe përmbajtja e formularit të aplikimit të ofertës do të miratohet nga METE, së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.6 Prokura e përfaqësimit

Në ofertën teknike, çdo Investitor i Interesuar (ose secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) do të paraqesë një prokurë përfaqësimi me shkrim, e cila tregon që personi(at) që nënshkruajnë ofertën ka(në) autoritetin për të nënshkruar ofertën dhe që oferta është detyruese për Investitorin e Interesuar (ose për secilin anëtar të konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) gjatë gjithë



periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Forma dhe përmbajtja e prokurës së përfaqësimit do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.7 Kushtet minimale teknike

Në ofertën teknike, Investitori i Interesuar duhet të konfirmojë angazhimin për të përmbushur kushtet minimale teknike për shoqërinë objekt, nëse ka, të cilat do të përcaktohen nga METE me miratimin e udhëzimeve për ofertuesit.

Kushtet minimale teknike do të përfshijnë përmbushjen e udhëzimeve të përgjithshme të IFC-së për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë, si dhe udhëzimeve të posaçme të IFC-së për sektorin apo udhëzime ekuivalente të praktikës së mirë ndërkombëtare të pranuar nga IFC, udhëzime të cilat mund të aksesohen në faqen e internetit:

<http://www.ifc.org/ifcext/sustainability.nsf/Content/EHSGuidelines>.

Përmbajtja e kushteve minimale teknike për operimin e shoqërinë objekt, së bashku me deklaratën e përputhshmërisë, do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.8 Kushtet minimale të punësimit

Në ofertën teknike, Investitori i Interesuar duhet të konfirmojë angazhimin për të përmbushur kushtet e pushimeve kolektive nga puna, të miratuara nga QSH-ja në lidhje me shoqërinë objekt.

Kushtet minimale të punësimit do të përfshijnë përmbushjen e standardeve të performancës 2 të IFC-së “Punësimi dhe kushtet e punës” të cilat mund të aksesohen në faqen e internetit:

<http://www.ifc.org/ifcext/sustainability.nsf/Content/EHSGuidelines>.

Përmbajtja e kushteve minimale të punësimit për shoqërinë objekt, së bashku me deklaratën e përputhshmërisë, do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.9 Deklarata e konfliktit të interesit

Në ofertën teknike, çdo Investitor i Interesuar (ose secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) do të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi konfliktin e interesit, në lidhje me çfarëdo konflikti interesi, të tanishëm, të mundshëm apo të ardhshëm, që

Investitori i Interesuar (ose secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) mund të ketë me procesin e tenderimit.

Forma dhe përmbajtja e deklaratës së konfliktit të interesit do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.10 Komisionet dhe shpërblimet

Në ofertën teknike, Investitor i Interesuar (ose secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) do të paraqesë informacion të detajuar i cili liston të gjitha komisionet dhe shpërblimet, nëse ka ndonjë, të paguar ose për t'u paguar nga Investitori i Interesuar (ose secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium), agjentëve dhe/ose ndërmjetësve në lidhje me ofertën apo marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve, së bashku me vlerën dhe valutën e paguar ose për t'u paguar dhe qëllimi i komisionit ose i shpenzimit. Nëse nuk ka pagesa komisionesh apo shpenzimesh, atëherë Investitori i Interesuar (ose secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) do ta pasqyrojë këtë informacion në ofertën teknike.

Forma dhe përmbajtja e deklaratës së komisioneve dhe shpërblimeve do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.11 Oferta financiare

Oferta financiare duhet të përmbajë çmimin e ofruar nga ofertuesi, "Çmimi i ofruar" për blerjen e titullit ligjor të njëqind për qind (100 %) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë objekt. Çmimi i ofruar duhet të shprehet si një vlerë fikse në euro, për t'u paguar nga fonde menjëherë të disponueshme, sipas kushteve dhe kriterëve të draftit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, në fuqi sipas miratimit të METE-s brenda afatit për paraqitjen e ofertave.

Në ofertën financiare duhet të deklarohet burimin e fondeve që do të përdoren për pagimin e çmimit të ofruar, dhe METE do të ketë të drejtën, nëse në rastet kur e konsideron të nevojshme, të kryejë verifikime në lidhje me burimin e këtyre fondeve.

Forma dhe përmbajtja e ofertës financiare do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.12 Sigurimi i ofertës

Si pjesë e ofertës financiare, Investitori i Interesuar duhet të paraqesë edhe garanci për sigurimin e ofertës në favor të METE-s, në vlerën 10%



te ofertes financiare te paraqitur. Sigurimi i ofertës do të jetë një letër garancie e lëshuar nga një bankë apo institucion financiar me reputacion dhe me aftësi paguese. Nëse institucioni që e lëshon sigurimin e ofertës është i themeluar jashtë Shqipërisë, sigurimi i ofertës duhet të lëshohet nga një degë shqiptare me reputacion dhe aftësi paguese ose një bankë korrespondente e themeluar në Shqipëri për ta bërë atë të zbatueshme.

Investitori i Interesuar duhet të garantojë që sigurimi i ofertës do të qëndrojë i vlefshëm, për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës (sipas përcaktimit të Paragrafit 6.2.1) dhe 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike pas çdo shtyrje afati të kërkuar nga METE në përputhje me paragrafin 6.2.2.

Ofertuesit fitues i kërkohet që të garantojnë që kushtet e sigurimit të ofertës të zgjaten dhe të kenë vlefshmëri për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike pas periudhës së realizimit të shitblerjes identifikuar sipas draftit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, në fuqi sipas miratimit të METE-s në momentin e skadimit të afatit për paraqitjen e ofertave, nëse vlefshmëria fillestare e sigurimit të ofertës është më e shkurtër sesa kjo periudhë.

Çdo ofertë e pashoqëruar me një sigurim oferte të si më sipër do të refuzohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave si e pavlefshme. Sigurimi i ofertës i një Investitori i Interesuar që është një konsorcium duhet të jetë në emër të të gjithë pjesëmarrësve të konsorciumit të cilët paraqesin ofertën.

Qëllimi i sigurimit të ofertës është që të garantojë që ofertuesi fitues, brenda 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike pas shpalljes së ofertuesit fitues, sipas përcaktimeve të paragrafit 9.6.1 do të zbatojë marrëveshjen për shitblerjen e aksioneve, thelbësisht sipas formës së draftit në fuqi miratuar nga METE brenda afatit të paraqitjes së ofertave, të sigluar nga Investitori i Interesuar (ose konsorciumi, nëse oferta paraqitet si konsorcium) në ofertën e tij teknike.

Forma dhe përmbajtja e sigurimit të ofertës do të miratohet nga METE, së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.13 Pagesa e tarifës së suksesit nga ofertuesi fitues

Ofertuesi fitues do të ketë detyrimin të paguajë, përveç çmimit të ofruar, një vlerë prej 430,000 (katërqind e tridhjetë mijë) eurosh në llogarinë bankare të *International Finance Corporation* (IFC), si tarifë suksesi e pagueshme për këtë transaksion.

Zotimi i ofertuesit për të paguar tarifën e suksesit do të jetë pjesë e ofertës financiare, për t'u miratuar nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.2 Vlefshmëria e ofertave

6.2.1 Periudha e vlefshmërisë së ofertave

Ofertat do të mbeten të vlefshme për periudhën që vijon afatin për paraqitjen e ofertave, siç detajohet në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat) të miratuara nga METE “Periudha e vlefshmërisë së ofertave”. Një ofertë e vlefshme për një periudhë më të shkurtër do të refuzohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave si e papranueshme.

6.2.2 Zgjatjet e afatit

Në rrethana të veçanta, METE mund të kërkojë miratimin e ofertuesve të cilët kanë paraqitur një ofertë, për një zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Kërkesa dhe përgjigjet e tilla duhet të bëhen me shkrim. Nëse ofertuesit pranojnë të zgjasin afatin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, sigurimi i ofertës duhet të zgjatet në përputhje me paragrafin e mësipërm 6.1.12 (dhe ofertuesit do të bëjnë përpjekjet e arsyeshme për këtë qëllim). Një ofertues mund të refuzojë kërkesën e METE-s për zgjatjen e afatit pa humbur sigurimin e tij të ofertës. Një ofertuesi, i cili e pranon kërkesën, nuk do t'i kërkohet dhe as nuk do t'i lejohet që të ndryshojë ofertën e tij.

6.3 Format i dhe nënshkrimi i ofertave

Investitori i Interesuar duhet të përgatisë një ofertë në origjinal dhe me një numër kopjesh sipas përcaktimeve të udhëzimeve për ofertuesit, duke shënuar në mënyrë të dukshme secilën, si origjinale apo si kopja nr. 1 etj. Në raste mospërputhjesh midis origjinalit dhe kopjeve, origjinali do të mbizotërojë.

Oferta në origjinal dhe të gjitha kopjet e ofertës do të nënshkruhen nga Investitori i Interesuar apo nga personi(at) e autorizuar rregullisht për të paraqitur investitorin/konsorciumin. Një autorizim i tillë duhet të dëshmohet nga një prokurë përfaqësimi me shkrim, e paraqitur si pjesë e ofertës teknike, në përputhje me paragrafin 6.1.6. Të gjitha faqet e ofertës, me përjashtim të literaturës së paraprintuar, duhet të nënshkruhet nga personi apo personat të cilët paraqesin këtë ofertë.

7. OFERTAT: PARAQITJA

7.1 Vulosja dhe shënjimi i ofertave



7.1.1 Zarfet e brendshme

Investitori i Interesuar duhet të mbyllë ofertën teknike dhe financiare për shoqërinë objekt, në zarfe të veçantë të vulosura, duke shënuar mbi këto zarfe:

Në një zarf të brendshëm të mbyllur, ku të jenë shënuar fjalët:

i) “OFERTË TEKNIKE - PËR PRIVATIZIMIN E “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” SHA”, zarf i cili duhet të përmbajë dokumentet e listuara në paragrafin 6.1.2 që përbëjnë ofertën teknike për “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” SHA”; dhe

në një zarf të brendshëm të mbyllur, ku të jenë shënuar fjalët:

ii) “OFERTË FINANCIARE – PËR PRIVATIZIMIN E “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” SHA”, zarf i cili duhet të përmbajë dokumentet e listuara në paragrafin 6.1.3 që përbëjnë ofertën financiare për – “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” SHA”.

7.1.2 Origjinali dhe kopjet

Zarfet e brendshme të përshkruara në paragrafin 7.1.1 më sipër, duhet të përgatiten në një origjinal dhe një numër kopjesh siç kërkohet në udhëzimet për ofertuesit. Zarfet që përmbajnë origjinalin dhe secilën kopje të ofertës teknike dhe financiare duhet të futen në zarfe të veçantë, ku të jenë shënuar fjalët:

“OFERTË – PËR PRIVATIZIMIN E “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” SHA - ORIGJINAL”/ OFERTË - PËR PRIVATIZIMIN E “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” SHA – KOPJA NR. 1”; e kështu me radhë;

7.1.3 Zarfet e jashtme

Zarfet e përshkruara në paragrafin 7.1.2 më sipër duhet të vendosen në një zarf të veçantë të jashtëm të mbyllur, ku të shënohet:

“OFERTË – PËR PRIVATIZIMIN E “HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2” SHA”.

Zarfi i jashtëm përshkruar në paragrafin 7.1.3 duhet të mbyllet dhe t’i dërgohet METE-s në adresën e dhënë në udhëzimet për ofertuesit dhe, gjithashtu, duhet të shënohen me fjalët “MOS HAPET PËRPARA DATËS _____.____.2012, ____:____am/pm, ora e Tiranës”, për t’u plotësuar me afatin e paraqitjes së ofertave siç është përcaktuar më poshtë në paragrafin 7.2 dhe në udhëzimet për ofertuesit.

7.1.4 Identifikimi i ofertuesit

Zarfet e brendshme të përshkruar në paragrafët 7.1.1 dhe 7.1.2 më sipër duhet të kenë të shënuar secili, emrin dhe adresën e Investitorit të Interesuar (ose nëse investitori është një konsorcium, të secilit anëtar të konsorciumit).

Nëse zarfi i jashtëm përshkruar në paragrafin 7.1.3 nuk është i mbyllur dhe i shënuar siç kërkohet më sipër, METE nuk do të mbajë përgjegjësi për ruajtjen e gabuar të zarfit të ofertës apo hapjen gabimisht të zarfit në mënyrë të parakohshme. Nëse zarfi i jashtëm tregon identitetin e ofertuesit, METE nuk garanton anonimitetin e dërgesës së ofertës, por ky identifikim nuk do të përbëjë arsye për refuzimin e ofertës.

7.1.5 Ofertat në mospërputhje

Çdo ofertë që nuk zbaton udhëzimet specifike në paragrafët e mësipërm të paragrafit 7, do të deklarohet në mospërputhje me dokumentet e ofertës dhe do të refuzohet nga komisioni i vlerësimit të ofertës.

7.2 Afati i paraqitjes së ofertave

7.2.1 Afati i paraqitjes së ofertave

Ofertat duhet të merren nga METE-s në adresën e përcaktuar në udhëzimet për ofertuesit jo më vonë se në orën dhe në datën e përcaktuar në udhëzimet për ofertuesit si “Afati i paraqitjes së ofertave”.

7.2.2 Zgjatjet e afatit

METE, në diskrecionin e saj, mund të zgjasë afatin e paraqitjes së ofertave duke ndryshuar udhëzimet për ofertuesit, si dhe duke njoftuar Investitorët e Interesuar në përputhje me paragrafin 5.3, në këtë rast të gjitha të drejtat dhe detyrimet e METE-s dhe Investitorëve të Interesuar do të jenë subjekte të afatit të zgjatur.

7.3 Ofertat e vonuara

Çdo ofertë e marrë nga METE pas afatit të paraqitjes së ofertave do të refuzohet dhe do t'i kthehet e pahapur Investitorit të Interesuar siç është parashikuar në paragrafin 8.6.3.

7.4 Ndryshimet dhe tërheqja e ofertave



Investitori i Interesuar nuk mund të ndryshojë ofertën e tij pas dërgimit të saj.

Investitori i Interesuar që dëshiron të tërheqë ofertën tij duhet të njoftojë më shkrim METE-n, njoftim i cili duhet të merret nga METE përpara afatit për paraqitjen e ofertave. Njoftimi i tërheqjes “Njoftim për tërheqje” duhet t’i dërgohet METE-s në adresën e deklaruar në udhëzimet për ofertuesit, dhe të ketë këtë lëndë:

- RE: “NJOFTIM PËR TËRHEQJE TË OFERTËS – PËR PRIVATIZIMIN E HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2 SH.A.”

Çdo njoftim për tërheqje i marrë pas afatit për paraqitjen e ofertave do të injorohet dhe oferta e marrë do të konsiderohet e dërguar rregullisht.

Çdo njoftim për tërheqje i marrë në intervalin ndërmjet afatit për paraqitjen e ofertave dhe skadimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës, përcaktuar në paragrafin 6.2, do të rezultojë në humbjen e sigurimit të ofertës, sipas paragrafit 6.1.12.

8. OFERTAT: HAPJA DHE VLERËSIMI

Procedurat e hapjes dhe vlerësimit të ofertave sipas paragrafit 8 do të jenë publike dhe do të realizohen nga komisioni për vlerësimin e ofertave në datën, orën dhe vendin e treguar në udhëzimet për ofertuesit. Nëse procedurat e hapjes dhe vlerësimit nuk mund të përfundohen brenda të njëjtës ditë, atëherë procesi do të shtyhet dhe rifillohet ditën e ardhshme të punës në të njëjtën orë dhe vend (përveç kur njoftohet ndryshe nga komisioni për vlerësimin e ofertave). Prania e pjesëmarrësve në momentin e hapjes mund të kufizohet për shkak të hapësirës fizike të disponueshme, me kusht që gjithsesi, pjesëmarrja e të paktën dy përfaqësuesve të secilit Investitor të Interesuar që ka dërguar ofertën të jetë e garantuar në çdo rast.

8.1 Hapja e zarfeve të jashtme

Përfaqësuesi(t) e Investitorëve të Interesuar që janë të pranishëm gjatë procedurave të hapjes dhe vlerësimit duhet të nënshkruajnë një regjistër i cili vërteton pjesëmarrjen e tyre.

Asnjë ofertë nuk do të refuzohet në hapjen e zarfeve me përjashtim të ofertave të vonuara në përputhje me paragrafin 7.3.

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të hapë njëkohësisht të gjithë zarfet e jashtme të mbyllur të përshkruar në paragrafin 7.1.3 dhe do të

lexojë me zë të lartë, në prani të përfaqësuesit(ve) të Investitorëve të Interesuar, emrin dhe adresën e secilit Investitor të Interesuar që ka paraqitur ofertën, duke përfshirë dhe faktin nëse oferta është marrë brenda afatit për paraqitjen e ofertave në përputhje me udhëzimet për ofertuesit.

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të hapë njëkohësisht të gjitha njoftimet për tërheqje në përputhje me paragrafin 7.4 dhe do të lexojë me zë, në prani të përfaqësuesit(ve) të Investitorëve të Interesuar, emrin dhe adresën e secilit Investitor të Interesuar që ka paraqitur njoftimin për tërheqje, duke përfshirë dhe faktin nëse njoftimi për tërheqje është marrë brenda afatit për paraqitjen e ofertave në përputhje me udhëzimet për ofertuesit.

8.2 Regjistrimi i rezultatit të hapjes

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të regjistrojë:

1. numrin total të ofertave dhe njoftimeve për tërheqje të marra;
2. numrin total të ofertave dhe njoftimeve për tërheqje të marra pas afatit për paraqitjen e ofertave me adresat dhe emrat e Investitorëve të Interesuar përkatës;
3. numrin total të ofertave dhe njoftimeve për tërheqje të marra brenda afatit për paraqitjen e ofertave me adresat dhe emrat e Investitorëve të Interesuar përkatës;

8.3 Hapja dhe vlerësimi i zarfeve të brendshme

Menjëherë pas përfundimit të procedurave të hapjes sipas paragrafit 8.1, në lidhje vetëm me ofertat sipas pikës 3 të paragrafit 8.2 më sipër, në lidhje me të cilat nuk është marrë një njoftim për tërheqje, komisioni i vlerësimit të ofertës do të hapë njëkohësisht:

1. Zarfet e përshkruara në paragrafin 7.1.3 që përmbajnë kopjen origjinale të ofertave; dhe
2. Zarfet e brendshme përkatëse të tyre, të përshkruar në paragrafin 7.1.1(i) që përmbajnë kopjet origjinale të ofertave teknike.

8.4 Ofertat teknike

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të lexojë me zë, në praninë e përfaqësuesit(ve) të Investitorëve të Interesuar, dhe do të regjistrojë përmbajtjen e secilës ofertë teknike të hapur në zbatim të paragrafit 8.3, së bashku me adresat dhe emrat e Investitorit të Interesuar që kanë paraqitur ofertën teknike.

8.5 Ofertat financiare



Komisioni i vlerësimit të ofertave hap në vijim zarfet e brendshme të përshkruara në paragrafin 7.1.1(ii) që përmbajnë ofertat financiare që rezultojnë nga procedura e hapjes sipas paragrafit 8.3.

8.5.1 Çmimi i ofruar

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të lexojë me zë të lartë, në prani të përfaqësuesit(ve) të Investitorëve të Interesuar, shumën e çmimit të ofruar nga secili Investitor i Interesuar dhe do të regjistrojë përmbajtjen e secilës ofertë financiare të hapur sipas këtij paragrafi 8.5, së bashku me adresat dhe emrat e Investitorit të Interesuar që ka paraqitur ofertën financiare.

8.6 Vlerësimi

8.6.1 Kontrolli i përputhshmërisë

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të shqyrtojë dokumentet që gjenden në zarfet e ofertave teknike të hapura sipas paragrafit 8.3 dhe do të përcaktojë nëse janë të plota, thelbësisht e formalisht në përputhje me këto procedura tenderi, si dhe me udhëzimet për ofertuesit (përfshirë shtojcat).

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të sigurojë veçanërisht që dokumentet e ofertës teknike të përputhen me kërkesat e paragrafit 6.1.2 dhe 6.1.4 deri më 6.1.10, me kërkesat e tjera të këtyre procedurave të tenderit dhe të udhëzimeve për ofertuesin (përfshirë shtojcat). Komisioni për vlerësimin e ofertave do të sigurojë, gjithashtu, që formulimi i draft marrëveshjes për shitblerjen e aksioneve të përputhet me versionin përfundimtar të marrëveshjes për shitblerjen e aksioneve i vënë në dispozicion nga METE përpara afatit për paraqitjen e ofertave.

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të shqyrtojë dokumentet që gjenden në zarfet e ofertave financiare sipas të hapura sipas paragrafit 8.3 dhe do të sigurohet se ato përputhen me të përputhen me kërkesat e paragrafit 6.1.3, 6.1.11 dhe 6.1.12, si dhe me kërkesat e tjera të këtyre procedurave të tenderit dhe të udhëzimeve për ofertuesin (përfshirë shtojcat).

8.6.2 Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i ofertave teknike do të bazohet në kriterin *kalon ose nuk kalon*, dhe nuk do të kryhet vlerësim me pikë për ofertat teknike.

Ofertat teknike që nuk kalojnë vlerësimin e përputhshmërisë sipas paragrafit 8.6.1 më sipër do të deklarohen si të pavlefshme ose në mospërputhje me dokumentet e ofertës sipas rastit dhe do të skualifikohen nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

Ofertat financiare që gjithashtu kalojnë vlerësimin e përputhshmërisë sipas paragrafit 8.6.1 më sipër do të renditen në bazë të çmimit më të lartë të ofruar.

8.6.3 Kthimi i dokumenteve

Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga dita e përfundimit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave sipas paragrafit 8, komisioni për vlerësimin e ofertave do të njoftojë zyrtarisht me shkrim Investitorët e Interesuar, ofertat e të cilëve janë deklaruar të vonuara, të pavlefshme dhe/ose në mospërputhje me procedurat dhe/ose me udhëzimet për ofertuesit (përfshirë shtojcat), për vendimin përfundimtar për përjashtimin të tyre nga procedurat e mëtejshme të procesit të ofertës.

Së bashku me këto njoftime, komisioni për vlerësimin e ofertave, gjithashtu, do të kthejë zarfet e përshkruara në paragrafët 7.1.1, 7.1.2 dhe 7.1.3, të cilët ishin të pahapura kur oferta u deklarua e tërhequr, e vonuar, e pavlefshme dhe/ose në mospërputhje, sipas rastit.

9. PROCEDURAT E MËTEJSHME

9.1 Pavlefshmëria dhe dështimi i procesit të tenderimit

Komisioni për vlerësimin e ofertave mund të tolerojë gabime materiale, mospërputhje ose parregullsi të vogla në një ofertë, të cilat nuk përbëjnë ndryshim thelbësor dhe që nuk paragjykojnë ose ndikojnë renditjen përkatëse të secilit Investitor të Interesuar si pasojë e vlerësimit të ofertës teknike dhe ofertës financiare.

9.1.1 Oferta të pavlefshme

Përveç rasteve të tjera të parashikuara shprehimisht, një ofertë do të deklarohet e pavlefshme kur:

1. Investitori i Interesuar nuk ka dhënë sigurimin e ofertës, apo siguri i ofertës nuk është në përputhje me kërkesat e këtyre procedurave të tenderit dhe të udhëzimeve për ofertuesin (përfshirë shtojcat);
2. Investitori i Interesuar (apo anëtar i konsorciumit kur oferta paraqitet si konsorcium) ka shkelur konfidencialitetin ose ka dhënë të dhëna të pavërteta në ofertën e tij/saj;



3. Investitori i Interesuar (apo anëtari i konsorciumit kur oferta paraqitet si konsorcium) nuk ka përmbushur ndonjë nga kërkesat e udhëzimeve për ofertuesit dhe dokumente të tjera të ofertës.

9.1.2 Dështimi i procesit të tenderimit

Procesi i tenderimit konsiderohet i pasuksesshëm, e për pasojë i dështuar, nëse:

1. asnjë nga ofertat nuk përmbush kërkesat e udhëzimeve për ofertuesit dhe dokumentet e tjera të ofertës;
2. Këshilli i Ministrave vendos të përfundojë procesin e tenderimit; ose
3. nuk është paraqitur asnjë ofertë.

9.2 Raporti i vlerësimit dhe njoftimi i ofertuesve

Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga data e përfundimit të procedurës sipas paragrafit 8, kryetari i komisionit të vlerësimit të ofertave përgatit një raport përmbledhës “Raporti i vlerësimit”, i cili përmban:

1. objektin e procesit të tenderimit dhe përqindjen e aksioneve të ofruara për shitje për shoqërinë objekt;
2. një përmbledhje të shkurtër të procedurës dhe të numrit të ofertave të dërguara për shoqërinë objekt;
3. një përmbledhje të ofertave të dërguara për shoqërinë objekt;
4. kriteret kryesore për vlerësimin e ofertave, dhe të vlerësimit të kryer për secilën ofertë për shoqërinë objekt;
5. kriteret e vlerësimit për ofertat financiare; dhe
6. një renditje të ofertuesve sipas çmimit të ofruar për shoqërinë objekt.

Raporti i vlerësimit paraqitet pranë METE-s për t’u dërguar më tej pranë Këshillit të Ministrave së bashku me propozimin e ofertuesit që ka propozuar çmimit të ofruar më të lartë për shoqërinë objekt sipas paragrafit 8.6.2.

9.3 Miratimi/refuzimi nga Këshilli i Ministrave

Këshilli i Ministrave shqyrton raportin e vlerësimit të propozuar nga komisioni për vlerësimin e ofertave dhe me diskrecion të tij:

1. Miraton raportin e vlerësimit dhe ofertën me çmimin e ofruar më të lartë për shoqërinë objekt; ose

2. Miraton raportin e vlerësimit por refuzon ofertën me çmimin e ofruar më të lartë për shoqërinë objekt nëse oferta financiare konsiderohet pa interes ekonomik; ose

3. Refuzon raportin e vlerësimit dhe kërkon korrigjime. Në këtë rast, komisioni i vlerësimit të ofertave bën korrigjimet e nevojshme, dhe raporti i vlerësimit paraqitet përsëri për miratim në përputhje me paragrafin 9.3.

Në vijim të miratimit nga Këshilli i Ministrave sipas pikave (1) më sipër, METE fiton të drejtën për të nënshkruar marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve me ofertuesin fitues, sipas paragrafit 9.5 më poshtë.

9.4 Përfundimi i procesit të tenderimit

Këshilli i Ministrave, në çdo kohë përpara shpalljes së ofertuesve fitues, mund të përfundojë procesin e tenderimit pa i dhënë ofertuesve asnjë argument justifikues.

METE nuk mban asnjë përgjegjësi në ushtrimin e ndonjë të drejte sipas këtij paragrafi.

9.5 Paragrafët përfundimtarë

9.5.1 Njoftimi i ofertuesit fitues

METE, në lidhje me shoqërinë objekt, i dërgon njoftimin e ofertuesit fitues, ofertuesit oferta e të cilit është pranuar nga Këshilli i Ministrave sipas paragrafit 9.3 “Ofertuesi fitues”. Ofertuesi fitues ftohet për ndjekur procedurat vijuese për finalizimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve dhe për nënshkrimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e miratimit të ofertuesit fitues nga Këshilli i Ministrave. Ofertuesi fitues mbetet i detyruar të zbatojë marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, sipas kopjeve të nënshkruara si pjesë e ofertës teknike, pa cenuar të drejtën e METE-s për të vendosur ndryshime të vogla me qëllim qartësimin dhe finalizimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve.

Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit si më sipër, ofertuesi fitues nuk zbaton kërkesat për zgjatjen e afatit të sigurimit të ofertës sipas paragrafit 6.1.11, nëse kjo zgjatje është nevojshme, dhe/ose nuk nënshkruan marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve, METE ka të drejtë të tërheqë sigurimin e ofertës së ofertuesit fitues dhe të ftojë Ofertuesit e tjerë të radhës, që kanë paraqitur një ofertë financiare të vlefshme sipas paragrafit 8.6.2, sipas renditjes së raportit të miratuar të



vlerësimit, derisa marrëveshja e shitblerjes së aksioneve të nënshkruhet, ose i propozon Këshillit të Ministrave të përfundojë procesin e tenderimit.

9.6 Kontaktimi me METE-n ose me autoritetet

Duke nisur nga momenti i hapjes së ofertave e deri në momentin e zbatimit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, nëse ndonjë ofertues dëshiron të kontaktojë METE-n, duhet ta bëjë nëpërmjet *e-mail*-it në adresën e përcaktuar në udhëzimin e METE-s, si dhe një kopje të çdo korrespondence dërguar grupit të projektit IFC: albaniahpps@ifc.org.

9.6.1 Finalizimi i marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve

Finalizimi i marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve me ofertuesin fitues do të kryhet me asistencën e International Finance Corporation (IFC).

Me nënshkrimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve nga ofertuesi fitues, METE do të njoftojë menjëherë me shkrim, sipas udhëzimeve për ofertuesit (përfshi shtojcat), çdo ofertuesi tjetër që ka dërguar një ofertë financiare të vlefshme sipas paragrafit 8.6.2.

9.7 Kthimi i ofertës dhe konfiskimi

METE do të kthejë sigurimin e ofertës të ofertuesve të pasuksesshëm që kanë paraqitur një ofertë financiare të vlefshme sipas paragrafit 8.6.2, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas mbarimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës siç është përcaktuar në paragrafin 6.2.1 dhe siç mund të shtyhet në përputhje me paragrafin 6.2.2.

Sigurimi i ofertës i ofertuesit fitues (sipas paragrafit 9.5) do të kthehet me përfundimin e afatit të realizimit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve nënshkruar mes palëve.

Sigurimi i ofertës mund të tërhiqet, me diskrecion të METE-s:

- Nëse ofertuesi (ose çdo anëtar i konsorciumit) bën ndonjë deklaram të pavërtetë material në ofertën e tij;
- Nëse ofertuesi tërheq ofertën gjatë periudhës së vlefshmërisë së ofertës;
- Nëse ofertuesi fitues nuk zbaton kërkesat për zgjatjen e afatit të sigurimit të ofertës sipas paragrafit 6.1.11, nëse kjo zgjatje është nevojshme, dhe/ose nuk nënshkruan marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve në formën e kopjes së nënshkruar, përfshirë në ofertën e tij, në një datë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas shpalljes së ofertuesit fitues sipas paragrafit 9.5.1; ose

- Nëse ofertuesi fitues nuk arrin të realizojë marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në të, për arsye që i atribuohen ofertuesit fitues.

Sigurimi i ofertës bëhet i tërheqshëm me kërkesën e parë të METE-s në rast se verifikohen një apo më shumë nga rrethanat e përshkruara në këtë paragraf.

Konfiskimi i sigurimit të ofertës nuk pengon METE-n që të marrë masa të tjera kundër ofertuesit fitues ose ndonjë ofertuesi tjetër.

Për më tepër, nëse një ofertues ose ofertuesi fitues: i) përdor mashtrimin në marrëdhëniet me METE-n, komisionin për vlerësimin e ofertave, këshilltarët e tij, punëmarrësit, konsulentët ose agjentët në lidhje me projektin; ose ii) provohet se, personalisht apo nëpërmjet një ndërmjetësi, direkt apo indirekt, ka ofruar ose është munduar të ofrojë ryshfet për ndonjë nga punëmarrësit e METE-s të përfshirë në ofertë ose në projekt, atëherë oferta e ofertuesit ose ofertuesit fitues do të anulohet dhe sigurimi i ofertës që do të konfiskohet.

9.8 Konfidencialiteti

METE dhe komisioni për vlerësimin e ofertave do të ruajnë konfidencialitetin e të gjitha të dhënave teknike, ekonomike dhe financiare që rrjedhin nga ofertat. Përveçse nëse parashikohet ndryshe nga ligji, vendimi i gjykatës ose nga udhëzimet për ofertuesin, METE dhe ofertuesit nuk do t'i shpërndajnë asnjë pale të tretë, informacione apo të dhëna teknike mbi çmimin dhe çdo element tjetër subjekt të diskutimeve, pa lejen e palës tjetër, me përjashtim të këshilltarëve dhe konsulentëve në lidhje me projektin.

9.9 Data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së shitjes së aksioneve

Pas nënshkrimit nga METE dhe nga ofertuesit fitues, marrëveshja e shitjes së 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare "HEC BISTRICA 1 dhe BISTRICA 2" sh.a. miratohet nga Kuvendi, bazuar në propozimin e Këshillit të Ministrave.



VENDIM
Nr. 677, datë 3.10.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 153, DATË 29.2.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË
INVESTITORËVE STRATEGJIKË PËR SHITJEN E 100% TË AKSIONEVE TË
SHOQËRISË AKSIONARE “HEC ULËZ-SHKOPET””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5 e 8 të ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a., “HEC Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., dhe përcaktimin e formës e të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a., dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca 1 bashkëlidhur dhe që përmendet në pikën 1 të vendimit nr. 153, datë 29.2.2012 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA 1

PROCEDURAT E TENDERIT DHE KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E INVESTITORËVE STRATEGJIKË PËR PRIVATIZIMIN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË ZOTËRUARA NGA SHTETI, QË PËRBËN 100% TË KAPITALIT TË SHOQËRISË “HEC ULËZ SHKOPET” SH.A

Procedurat dhe kriteret e këtij tenderi janë përgatitur në përputhje me nenin 3 dhe 8 të ligjit nr. 8306 datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., “Hec Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sh.a.” dhe përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

1. HYRJE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë “QSH” ka ndërmarrë një sërë iniciativash në sektorin e energjisë, përfshirë dhe procesin e liberalizimit dhe privatizimit të tregut të energjisë, si rrjedhojë e aderimit në Traktatin që themelon Komunitetin e Energjisë, nënshkruar më 25 tetor 2005 në Athinë.

Masat kryesore të ndërmarra nga QSH, për liberalizimin e tregut të energjisë, midis të tjerave janë:

- Shkëputja nga KESH e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST);
- Shkëputja nga KESH e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
- Vendosja e rregullave të reja liberalizuese për tregun e energjisë, duke miratuar Modelin e ri të Tregut të Energjisë (vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19 mars 2008 “Mbi miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë”) dhe rregullat e reja të tregut të energjisë (vendimi i Entit Rregullator ERE nr. 68, datë 23 qershor 2008);
- Privatizimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), i shkëputur nga KESH.

QSH planifikon të zhvillojë më tej strategjinë e nisur prej saj, duke tërhequr investime të mëtejshme të huaja në sektorin shqiptar të energjisë, dhe veçanërisht në projektet e prodhimit të energjisë hidrike.

QSH, nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “METE” së Republikës së Shqipërisë ose “Shitësi”, dëshiron të



privatizojë 100% të kapitalit të shoqërisë aksionare “HEC ULËZ SHKOPET” sh.a., në vijim “Shoqëria Objekt”, e cila ka selinë e regjistruar në: Dibër Burrel, Ulëz, Burrel, Shqipëri, regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me numër unik identifikimi L183069010.

Shoqëria objekt është e angazhuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë nga burime hidrike dhe të shitjes së energjisë elektrike. Privatizimi i shoqërisë objekt do të realizohet me anë të shitjes së njëqind për qind (100%) të aksioneve të kapitalit saj, të zotëruar nga METE, në vijim “Paketa aksionare”, në favor të investitorit strategjik të përzgjedhur sipas këtyre procedurave të tenderit, në vijim “Projekti”.

Me synimin për të tërhequr investitorët strategjikë optimalë, operimin dhe zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë objekt, QSH-ja ka vendosur të nisë procedurat e tenderit të hapur ndërkombëtar “Procesi i tenderimit”, për lidhjen e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, “Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve”, midis METE dhe investitorit strategjik të përzgjedhur sipas këtyre procedurave të tenderit.

METE dhe/ose QSH, sipas rastit, rezervojnë të drejtën që në çdo kohë të rishikojnë apo anulojnë procesin e tenderimit për shoqërinë objekt, ose të refuzojnë çfarëdo rekomandim të dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave ose të mos lidhin marrëveshje me asnjërin nga ofertuesit, pa asnjë kosto e pa asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve për METE dhe/ose QSH, apo çdo ministrie, për komisionin e vlerësimit të ofertave, ose ndonjë përfaqësues të tyre, apo çdo anëtar apo personi tjetër, edhe nëse ka pasur dëme apo shpenzime të kryera, si dhe të rishikojnë procedurat e tenderit dhe/ose udhëzimet për ofertuesit.

Gjatë periudhës së vlefshmërisë së ofertës, deri në ekzekutimin dhe mbylljen e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, asnjë ofertues nuk do të ketë asnjë të drejtë në lidhje me shoqërinë objekt, si rezultat i paraqitjes së një oferte dhe/ose pjesëmarrjes në procesin e tenderimit dhe as METE, as QSH nuk kanë asnjë detyrim të lidhin një marrëveshje shitblerje aksionesh.

2. NJOFTIMI PUBLIK

METE do të publikojë një njoftim për procesin e tenderimit sipas VKM nr. 329 datë 12/07/1999 të ndryshuar. Afatet kohore për nisjen e publikimit do të miratohen nga METE së bashku me “Udhëzimet për Ofertuesit”. Publikimi i njoftimit për fillimin e procesit të tenderimit do të kryhet në përputhje me kriteret e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga

shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

3. RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË TENDERIMIT

3.1 Ligji i zbatueshëm

Procesi i tenderimit do të kryhet dhe do të rregullohet duke zbatuar procedurat e tenderit të përcaktuara sipas këtij dokumenti, si dhe nga udhëzimet për ofertuesit (përfshirë shtojcat), të miratuara nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3.2 Tender ndërkombëtar

Procesi i tenderimit është një tender i hapur ndërkombëtar me një fazë. Procesi i identifikimit dhe i pranimi të investitorëve strategjikë bëhet në përputhje me këto Procedura të Tenderit dhe udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat), të miratuara nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3.3. Gjuha

Gjuha e procesit të tenderimit do të jetë gjuha angleze dhe gjuha shqipe. Propozimet teknike dhe financiare, të paraqitura nga ofertuesit, si dhe korrespondenca dhe dokumentet që i përkasin ofertës duhet të paraqiten në anglisht, me përjashtimin që çfarëdo informacioni të paraprintuar që mund të paraqitet nga ofertuesi në një gjuhë tjetër, por me kusht që pjesët e rëndësishme përkatëse, të jenë të shoqëruara me përkthimin në gjuhën angleze, vërtetuar në vendin e origjinës së ofertuesit.

3.4 Pranimi i kushteve të procesit të tenderimit

Paraqitja e një oferte nga një ofertues nënkupton njohjen dhe pranimin e plotë të të gjitha kushteve të përcaktuara në këto procedura tenderi dhe në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat e saj), si dhe të të gjitha përgjegjësiqve që rrjedhin në rast se shpallet si ofertuesi fitues (siç përcaktohet në paragrafin 9.5.1).

3.5 Përkufizimet

Sa herë që përdoren në këto procedura tenderi, përveçse nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar si më poshtë, bashkëlidhur, nëse një term nuk është përkufizuar në këto procedura tenderi, atëherë termi do të ketë kuptimin e përcaktuar në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat), të cilat miratohen nga METE. Në rastet e konfliktit midis



termave të përcaktuar në këtë dokument dhe të njëjtave terma të përshtatur ndryshe në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat), përveçse nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e përshtatur në këto procedura tenderi do të mbizotërojnë dhe do të zbatohen, gjithashtu, edhe në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat).

Përkufizimet janë:

“Afati i paraqitjes së ofertave” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 7.2.1.

“Autoritetet” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 5.4.

“Çmimi i ofruar” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.1.11.

“Kalendari i parashikuar” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 5.5.

“Konsorcium” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 4.1.

“Kryesues” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 4.1.

“Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“METE” ose **“Shitësi”** ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Njoftim për tërheqje” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 7.4.

“Ofertë” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 4.1.

“Oferta financiare” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.1.3.

“Oferta teknike” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.1.2.

“Ofertuesi fitues” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 9.5.1.

“Ofertuesit” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 4.1.

Investitori i Interesuar është investitori individual apo Konsorciumi, i interesuar për privatizimin e 100% të aksioneve të Shoqërisë Objekt. Kurdo që përdoren në këto procedura, termi Investitor i Interesuar do t'i referohet Konsorciumit në tërësi, siç është përcaktuar në paragrafin 4.1, përveç se kur dispozita i referohet në mënyrë posaçme individualit anëtarëve të Konsorciumit.

“Paketa aksionare” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Periudha e vlefshmërisë së ofertave” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.2.1.

“Përgjigje ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 5.2.

“Procedurat e tenderit”, procedurat për privatizimin e paketës së aksioneve të shoqërisë objekt.

“Procesi i tenderimit” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Projekti” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“QSH” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Raporti i vlerësimit” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 9.2.

“Sigurimi i ofertës” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.1.12.

“Shpenzimet e ofertës” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 3.6.

“Shoqëria objekt” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Udhëzime për ofertuesit” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 2.

3.6 Kostot

Investitorët e Interesuar do të përballojnë të gjitha kostot në lidhje me kryerjen e verifikimeve (*due diligence*) të tyre dhe përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës, dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e tenderimit, “shpenzimet e ofertës” përfshirë pa kufizim, të gjitha kostot dhe shpenzimet në lidhje me përfshirjen e Investitorit të Interesuar në:

- Grumbullimin e të gjithë informacionit tjetër, përfshirë verifikimet (*due diligence*);
- Intervistat;
- Përgatitjen e përgjigjeve ndaj pyetjeve ose kërkesave për sqarim nga METE;
- Përgatitjen e kërkesave gjatë procesit të sqarimit; dhe
- Diskutimet për marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve.

METE nuk do të jetë përgjegjëse dhe nuk do të ketë detyrimin të paguajë asnjë shpenzim për ofertën të kujt do Investitori të Interesuar, pavarësisht nga kryerja apo ndërprerja e procesit të tenderimit.

4. OFERTUESIT

4.1 Investitori Strategjik

Oferta të vlefshme do konsiderohen ofertat e Investitorëve të Interesuar, të cilët janë investitor strategjikë, sipas përkufizimit vijues, që do të quhen “Ofertuesit”:

1. Të jenë themeluar (në përputhje me legjislacionin që i zbatohet themelimit të tyre) si person juridik, me personalitet ligjor të ndryshëm nga ai i ortakëve/aksionarëve të tij;
2. Të kenë aftësi paguese dhe të mos jenë në procese falimentimi apo në procedura likuidimi;
3. Të zotërojnë burime njerëzore, teknike, profesionale, eksperiencë organizative ne menaxhimin e kompanive të mëdha;
4. Të zotërojnë burime financiare që nga llogaritë financiare të vitit të fundit financiar, të jenë të paktën të barabarta me 25 milionë euro (ose ekuivalenti në një monedhë tjetër).

Forma dhe përmbajtja e dokumenteve që vërtetojnë përmbushjen e këtyre kritereve do të miratohen nga METE, së bashku me udhëzimet për ofertuesit. Vlerësimi i këtyre kritereve dhe lëshimi i ftesës për ofertë do të jetë në diskrecionin e plotë të METE-s.



Oferta mund të paraqitet nga një konsorciumit midis disa Investitorëve të Interesuar të veçantë, duke pasur parasysh që një kopje e nënshkruar e marrëveshjes së konsorciumit duhet t'i dorëzohet METE-s, së bashku me dokumentacionin përkatës (siç kërkohet në udhëzimet për ofertuesit) për secilin anëtar, në lidhje me kriteret e mësipërme.

Për qëllim të këtyre procedurave tenderimi “Konsorcium” do të përkufizohet një marrëveshje *jonit-venture*, konsorcium ose çdo lloj tjetër marrëveshjeje e ngjashme për bashkimin e përkohshëm të ndërmarrjeve, pavarësisht nga titulli apo cilësimi ligjor në bazë të legjislacionit të zbatueshëm në vendin e origjinës nga vjen ky bashkim, i cili ka si objekt pjesëmarrjen e përbashkët në procesin e tenderimit dhe paraqitjen e përbashkët të një oferte për shoqërinë objekt. Anëtarët e konsorciumit nuk do të lejohen të ndryshojnë kushtet e marrëveshjes së konsorciumit gjatë procesit të tenderimit, dhe më tej, sipas marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, pa miratimin paraprak me shkrim të METE-s, i cili do të jetë në diskrecionin e saj.

Marrëveshja e konsorciumit duhet të tregojë anëtarin i cili do të jetë “kryesues” i konsorciumit, i cili do të ketë shumicën e pjesëmarrjes në konsorcium, dhe të cilit do t'i adresohet METE për të gjitha qëllimet gjatë procesit të tenderimit. Njoftimet e METE-s ndaj kryesuesit, dhe përgjigjet e kryesuesit do të jenë të detyrueshme edhe për anëtarët e tjerë të konsorciumit.

Çfarëdo ndryshimi i kushteve të marrëveshjes së konsorciumit gjatë procesit të tenderimit, pa miratimin paraprak me shkrim nga ana e METE-s, do të shkaktojë skualifikimin e konsorciumit dhe të anëtarëve të tij.

Nëse Oferta është paraqitur si konsorcium, atëherë çdo anëtar i konsorciumit duhet të përmbushë të paktën kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij paragrafi 4.1, me kusht që konsorciumi në tërësi, duhet të përmbushë të gjitha kriteret nga 1 në 5 të këtij paragrafi 4.1.

Vetëm Investitorët e Interesuar që plotësojnë këto kritere do të paraqesin një “Ofertë” sipas paragrafëve 6 dhe 7.

Një Ofertë e paraqitur nga Investitorët e Interesuar që nuk përmbush kërkesat sipas paragrafit 4.1 do të skualifikohet.

4.2 Kufizimet

Çdo investitor mund të marrë pjesë në procesin e tenderimit vetëm si një Investitor i Interesuar i veçantë, ose si anëtar i një konsorciumi të vetëm

dhe secili Investitor i Interesuar i veçantë apo Konsorcium, mund të paraqesë vetëm një ofertë (siç është përshkruar në paragrafin 6 dhe 7).

Një Investitor i Interesuar i veçantë do të konsiderohet si pjesëmarrës në procesin e tenderimit kur:

- a) Investitor i Interesuar i veçantë ka paraqitur një Ofertë; ose
- b) Investitor i Interesuar i veçantë është anëtar i një Konsorciumi i cili ka paraqitur një Ofertë;

5. DOKUMENTET E TENDERIT

5.1 Përmbajtja e dokumenteve të tenderit

Dokumentet e tenderit përfshijnë:

1. Ligjin nr. 8306 datë 14.3.1998 “Për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë”;
2. Ligjin nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a., “Hec Tiranë, Lanabregas” sh.a., dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sh.a.” dhe përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.”;
3. Vendimin e Këshillit të Ministrave që miraton këto procedura tenderi;
4. Udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat) të miratuara me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
5. Memorandumi informativ (CV) për shoqërinë;
6. Ekstrakti regjistrimi tregtar për “HEC ULËZ SHKOPET” sh.a.;
7. Akti i themelimit/statut i “HEC ULËZ SHKOPET” sh.a.;
8. Bilanci dhe raporti i auditimit të “HEC ULËZ SHKOPET” sh.a. për vitin 2011.

Një kopje e të gjitha dokumenteve të tenderit si më sipër do t’i jepet çdo Investitori të Interesuar që i kërkon ato. Investitor i Interesuar që ka nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti me METE mund të marrë akses në të dhënat konfidenciale të dhomës së të dhënave të Projektit.

Secili Investitor i Interesuar do të verifikojë nën përgjegjësinë e tij të gjitha udhëzimet, kushtet dhe kriteret, format, specifikimet dhe çdo informacion tjetër të përfshirë në këto procedura tenderi dhe në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat). Nëse Investitor i Interesuar:

- a) Nuk arrin të paraqesë të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar nga këto procedura tenderi dhe udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat); ose



b) Paraqet një ofertë e cila nuk përputhet në thelb me kushtet dhe kriteret e këtyre procedurave të tenderit dhe të udhëzimeve për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat), atëherë këto veprime janë nën riskun e Investitor i Interesuar dhe komisioni i vlerësimit të ofertave mund të deklarojë ofertën në mospërputhje me këto procedura tenderi dhe udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat); dhe mund ta refuzojë atë.

5.2 Sqarime mbi dokumentet e tenderit

Një Investitor i Interesuar i cili kërkon ndonjë sqarim apo ndryshim të udhëzimeve për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat) mund të njoftojë METE-n me *e-mail* në adresën e përcaktuar udhëzimin për ofertuesit dhe një kopje të saj te konsulenti IFC albaniahpps@ifc.org. Në të njëjtën mënyrë, nëse një Investitor i Interesuar mendon që ndonjë parashikim i rëndësishëm i udhëzimeve për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat) është i papranueshëm, mund ta ngrejë këtë çështje në çdo kohë, përpara afatit për paraqitjen e ofertave, siç specifikohet në kalendarin e parashikuar (përcaktuar më poshtë në paragrafin 5.5) pa paragjykuar të drejtën e diskrecionalitetit të METE-s për ta pranuar ose jo këtë kërkesë për ndryshim.

Çdo kërkesë për sqarim apo ndryshim të udhëzimeve të ofertës (përfshirë dhe shtojcat) duhet të merret (në mënyrën e përshkruar në paragrafin 5.2) jo më vonë se në datën e përcaktuar në kalendarin e parashikuar. Kopjet elektronike të përgjigjeve (nëse ka), përfshirë dhe një shpjegim të çështjes, por jo identifikimin e burimit “Përgjigje ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin”, do të vihen në dispozicion nga METE (apo nga personi i autorizuar nga METE) në dhomën e të dhënave të Projektit. Nëse pyetje të ngjashme apo të përsëritura bëhen nga Investitor i Interesuar, këto pyetje mund të listohen si një e vetme dhe METE mund t’i përgjigjet kësaj pyetjeje vetëm një herë. Asnjë përgjigje dhe/ose informacion ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin e dhënë me gojë apo me shkrim do të jetë detyruese për palët. Vetëm marrëveshja e shitblerjes së aksioneve dhe shtojcat e saj, nëse është lidhur në mënyrë të rregullt, do të ketë forcën e ligjit dhe do të jetë detyruese për palët.

METE do të organizojë 1 (një) raund komentesh, në mënyrë që Investitor i Interesuar të kenë mundësinë që të paraqiten dhe të diskutojnë me METE-n në lidhje me komentet e tyre me shkrim mbi udhëzimet e ofertës, përfshirë dhe marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve.

5.3 Ndryshimet e udhëzimeve të ofertës (përfshirë dhe shtojcat)

Në çdo moment para afatit për paraqitjen e ofertave (siç përcaktohet në paragrafin 7.2) METE mundet që, për çdo arsye, qoftë me iniciativën e saj apo si përgjigje ndaj sqarimeve të kërkuara nga një Investitor i

Interesuar, të ndryshojë udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat). Asnjë komunikim tjetër i çfarëdo lloji, përfshirë por pa u kufizuar, përgjigjet ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin, nuk do të ndryshojë udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat).

Ndryshimet do të vihen në dispozicion nga METE (apo nga personi i autorizuar nga METE) në dhomën e të dhënave të Projektit.

5.4 Informacioni i dhënë nga autoritetet/verifikimet e ofertuesit

Secili Investitor i Interesuar është i vetmi përgjegjës për kryerjen e kërkimeve të pavarura, verifikimeve (*due diligence*) dhe çdo pune apo hetimi dhe për marrjen e çdo këshillimi tjetër të pavarur, me shpenzimet e tij, për përgatitjen e ofertës së tij dhe negocimit dhe përfundimit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve.

Asnjë përfaqësim apo garanci, e shprehur ose e nënkuptuar, nuk jepet dhe nuk do të ketë asnjë përgjegjësi të asnjë lloji për METE-n, stafin e saj apo agjentët e saj “Autoritetet” apo këshilluesit e tyre, punëmarrësit, konsulentët apo agjentët, për plotësinë apo saktësinë e çdo informacioni të përfshirë në dokumentet e ofertës ose në përgjigjen ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin, ose informacioni tjetër të dhënë gjatë procesit të tenderimit apo gjatë negociatave për marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve. Autoritetet dhe këshilluesit e tyre, punëmarrësit, konsulentët dhe agjentët nuk do të jenë përgjegjës ndaj asnjë personi apo shoqërie si rezultat i përdorimit të ndonjë informacioni të përfshirë në dokumentet e tenderimit, në përgjigjet ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin apo dhënë gjatë procesit të tenderimit ose gjatë negociatave për përfundimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve.

Investitori i Interesuar nuk do të mbështeten mbi asnjë deklaram të bërë me gojë nga “Autoritetet”, këshilluesit, punëmarrësit, konsulentët dhe agjentët e tyre.

Të gjithë Investitorët e Interesuar, para se të paraqesin ofertat e tyre, duhet të kontrollojnë të gjitha kriteret për përputhshmërinë me legjislacionin për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe kriteret e tjera të cilat i zbatohen shoqërive tregtare të cilat dëshirojnë të ushtrojnë veprimtari tregtare në Shqipëri.

Investitorët e Interesuar janë përgjegjësit e vetëm për të gjitha çështjet në lidhje me aftësinë e tyre ligjore për të operuar në juridiksionin nën të cilin zhvillohet procesi i tenderimit.



Çdo informacion i dhënë nga “Autoritetet” gjatë zhvillimit të verifikimeve, do të jetë objekt i marrëveshjes së konfidencialitetit të nënshkruar nga të gjithë Investitorët e Interesuar.

5.5 Afatet kohore

Në këto procedura tenderi një ditë pune zyrtare, përveçse nëse është parashikuar ndryshe në dokumentet standarde të tenderit, do të jetë një nga ditët e javës, përjashtuar të shtunat dhe të dielat dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

Një kalendar i parashikuar për procesin e tenderimit është përfshirë në udhëzimet për ofertuesit “Kalendar i parashikuar”.

METE mundet që në diskrecionin e saj dhe pa njoftim paraprak ndaj Investitorëve të Interesuar, të ndryshojë kalendarin e parashikuar dhe të njoftojë Investitorët e Interesuar mbi këtë ndryshim, nëpërmjet një njoftimi në dhomën e të dhënave të Projektit.

Investitorët e Interesuar nuk do të mbështeten në asnjë mënyrë në kalendarin e parashikuar dhe METE nuk do të ketë asnjë përgjegjësi si pasojë e ndryshimeve të kalendarit të parashikuar.

6. OFERTAT: PËRGATITJA

6.1 Përgatitja e ofertave

6.1.1 Dokumentet përbërëse të ofertës

Kur paraqitet një ofertë në përputhje me paragrafin 7, secili Investitor i Interesuar mund të paraqesë një ofertë në lidhje me “HEC ULËZ SHKOPET” sh.a.

Çdo e dhënë e rreme do të konsiderohet si e mjaftueshme për skualifikimin e Investitorit të Interesuar dhe çdo zbulim që Investitori i Interesuar ka paraqitur informacion të rremë ose informacion të mbajtur të fshehur në ofertën e tij do të konsiderohet si shkak për zgjidhjen e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve.

Investitorët e Interesuar duhet të përdorin vetëm dokumentet standarde të procesit të tenderimit, pa bërë asnjë ndryshim të kushteve të tyre. Asnjë shënim mbi formatet e miratuara, përfshirë dhe ofertat teknike dhe financiare nuk do të pranohet. Ofertat e kushtëzuara nuk pranohen.

Çdo ofertë e paraqitur si më sipër, duhet të përbëhet nga dokumentet e mëposhtme:

6.1.2 Oferta teknike

Propozimi teknik, i përbërë nga dokumentet e mëposhtme, së bashku "Oferta teknike":

- a) Dokumentacioni i Kualifikimit të Ofertuesit sipas kërkesave të paragrafit 6.1.4;
- b) Formulari i aplikimit të ofertës sipas kërkesave të paragrafit 6.1.5;
- c) drafti final i marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, me secilën faqe të sigluar nga Investitori i Interesuar;
- d) Prokurë përfaqësimi me formën dhe përmbajtjen e kërkuar sipas paragrafit 6.1.6;
- e) Konfirmimi i kushteve teknike minimale sipas kërkesave të paragrafit 6.1.7;
- f) Konfirmimi i kushteve minimale të punësimit, sipas kërkesave të paragrafit 6.1.8;
- g) Deklarata e konfliktit të interesit sipas kërkesave të paragrafit 6.1.9;
- h) Deklarata e komisioneve dhe shpërblimeve sipas kërkesave të paragrafit 6.1.10;

6.1.3 Oferta financiare

Propozimi financiar, i përbërë nga dokumentet e mëposhtme, së bashku "oferta financiare":

- a) Formulari i ofertës financiare, sipas kërkesave të paragrafit 6.1.110 më poshtë;
- b) Sigurimi i ofertës, me formën dhe përmbajtjen e kërkuar sipas paragrafit 6.1.12;

6.1.4 Dokumentacioni i Kualifikimit të Ofertuesit

Secili Investitor i Interesuar që paraqet një ofertë (individualisht apo si konsorcium) do të paraqesë dokumentet vijues:

- a) certifikatë origjinale e regjistrimi ose ekstrakt i regjistrit tregtar për Investitorin e Interesuar (apo për secilin anëtar të konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium), e cila tregon statusin e regjistrimit si person juridik me personalitet të ndarë nga ortakët/aksionarët e tij;
- b) certifikatë origjinale e lëshuar nga gjykata, regjistri tregtar ose autoritet tjetër në juridiksionin përkatës, e cila tregon se Investitori i Interesuar (apo secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) nuk ka deklaruar faliment ose nuk është i përfshirë në procedura likuidimi;



- c) pasqyrat financiare të audituara/paaudituar të vitit të fundit financiar të Investitorit të Interesuar (apo për secilin anëtar të konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium);
- d) Curriculum Vitae e Investitorit të Interesuar (apo për secilin anëtar të konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) me informacion mbi eksperiencën teknike dhe profesionale;
- e) Original i marrëveshjes së konsorciumit mes Investitorëve të Interesuar, nëse oferta paraqitet si Konsorcium;

Të gjitha dokumentet e mësipërme duhet të jenë në gjuhën angleze, ose të shoqëruara me përkthimin në gjuhën angleze, të certifikuar në vendin e themelimit të kandidatit (ose anëtarëve të konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium). Dokumentet e përshkruara në pikën 1 dhe 2 më sipër duhet të jenë lëshuar jo më parë se 30 ditë kalendarike nga data e fundit e afatit për paraqitjen e ofertave, dhe duhet të mbajnë vulën e Apostilës në përputhje me Konventën e Hagës mbi Heqjen e Kërkesave për Legalizimin e Dokumenteve të Huaja Publike (ose të jenë legalizuar nga autoritetet përkatëse diplomatike Shqiptare).

6.1.5 Formulari i aplikimit të ofertës

Forma dhe përmbajtja e formularit të aplikimit të ofertës do të miratohet nga METE, së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.6 Prokura e përfaqësimit

Në ofertën teknike, çdo Investitor i Interesuar (ose secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) do të paraqesë një prokurë përfaqësimi me shkrim, e cila tregon që personi(at) që nënshkruajnë ofertën ka(në) autoritetin për të nënshkruar ofertën dhe që oferta është detyruese për Investitorin e Interesuar (ose për secilin anëtar të konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Forma dhe përmbajtja e prokurës së përfaqësimit do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.7 Kushtet minimale teknike

Në ofertën teknike, Investitori i Interesuar duhet të konfirmojë angazhimin për të përmbushur kushtet minimale teknike për shoqërinë objekt, nëse ka, të cilat do të përcaktohen nga METE me miratimin e udhëzimeve për ofertuesit.

Kushtet minimale teknike do të përfshijnë përmbushjen e udhëzimeve të përgjithshme të IFC-së për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë, si dhe udhëzimeve të posaçme të IFC-së për sektorin apo udhëzime ekuivalente të praktikës së mirë ndërkombëtare të pranuar nga IFC, udhëzime të cilat mund të aksesohen në faqen e internetit:

<http://www.ifc.org/ifcext/sustainability.nsf/Content/EHSGuidelines>.

Përmbajtja e kushteve minimale teknike për operimin e shoqërinë objekt, së bashku me deklaratën e përputhshmërisë, do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.8 Kushtet minimale të punësimit

Në ofertën teknike, Investitori i Interesuar duhet të konfirmojë angazhimin për të përmbushur kushtet e pushimeve kolektive nga puna, të miratuara nga QSH-ja në lidhje me shoqërinë objekt.

Kushtet minimale të punësimit do të përfshijnë përmbushjen e standardeve të performancës 2 të IFC-së “Punësimi dhe kushtet e punës” të cilat mund të aksesohen në faqen e internetit:

<http://www.ifc.org/ifcext/sustainability.nsf/Content/EHSGuidelines>.

Përmbajtja e kushteve minimale të punësimit për shoqërinë objekt, së bashku me deklaratën e përputhshmërisë, do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.9 Deklarata e konfliktit të interesit

Në ofertën teknike, çdo Investitor i Interesuar (ose secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) do të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi konfliktin e interesit, në lidhje me çfarëdo konflikti interesi, të tanishëm, të mundshëm apo të ardhshëm, që Investitori i Interesuar (ose secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) mund të ketë me procesin e tenderimit.

Forma dhe përmbajtja e deklaratës së konfliktit të interesit do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.10 Komisionet dhe shpërblimet

Në ofertën teknike, Investitor i Interesuar (ose secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) do të paraqesë informacion të detajuar i cili liston të gjitha komisionet dhe shpërblimet, nëse ka ndonjë, të paguar ose për t’u paguar nga Investitori i Interesuar (ose secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium),



agjentëve dhe/ose ndërmjetësve në lidhje me ofertën apo marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve, së bashku me vlerën dhe valutën e paguar ose për t'u paguar dhe qëllimi i komisionit ose i shpenzimit. Nëse nuk ka pagesa komisionesh apo shpenzimesh, atëherë Investitori i Interesuar (ose secili anëtar i konsorciumit, nëse oferta paraqitet si konsorcium) do ta pasqyrojë këtë informacion në ofertën teknike.

Forma dhe përmbajtja e deklaratës së komisioneve dhe shpërblimeve do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.11 Oferta financiare

Oferta financiare duhet të përmbajë çmimin e ofruar nga ofertuesi, "Çmimi i ofruar" për blerjen e titullit ligjor të njëqind për qind (100 %) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë objekt. Çmimi i ofruar duhet të shprehet si një vlerë fikse në euro, për t'u paguar nga fonde menjëherë të disponueshme, sipas kushteve dhe kritereve të draftit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, në fuqi sipas miratimit të METE-s brenda afatit për paraqitjen e ofertave.

Në ofertën financiare duhet të deklarohet burimin e fondeve që do të përdoren për pagimin e çmimit të ofruar, dhe METE do të ketë të drejtën, nëse në rastet kur e konsideron të nevojshme, të kryejë verifikime në lidhje me burimin e këtyre fondeve.

Forma dhe përmbajtja e ofertës financiare do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.12 Sigurimi i ofertës

Si pjesë e ofertës financiare, Investitori i Interesuar duhet të paraqesë edhe garanci për sigurimin e ofertës në favor të METE-s, në vlerën 10% të ofertes financiare të paraqitur. Sigurimi i ofertës do të jetë një letër garancie e lëshuar nga një bankë apo institucion financiar me reputacion dhe me aftësi pague. Nëse institucioni që e lëshon sigurimin e ofertës është i themeluar jashtë Shqipërisë, sigurimi i ofertës duhet të lëshohet nga një degë shqiptare me reputacion dhe aftësi pague ose një bankë korrespondente e themeluar në Shqipëri për ta bërë atë të zbatueshme.

Investitori i Interesuar duhet të garantojë që sigurimi i ofertës do të qëndrojë i vlefshëm, për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës (sipas përcaktimit të Paragrafit 6.2.1) dhe 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike pas çdo shtyrje afati të kërkuar nga METE në përputhje me paragrafin 6.2.2.

Ofertuesit fitues i kërkohet që të garantojnë që kushtet e sigurimit të ofertës të zgjaten dhe të kenë vlefshmëri për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike pas periudhës së realizimit të shitblerjes identifikuar sipas draftit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, në fuqi sipas miratimit të METE-s në momentin e skadimit të afatit për paraqitjen e ofertave, nëse vlefshmëria fillestare e sigurimit të ofertës është më e shkurtër sesa kjo periudhë.

Çdo ofertë e pashoqëruar me një sigurim oferte të si më sipër do të refuzohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave si e pavlefshme. Sigurimi i ofertës i një Investitori i Interesuar që është një konsorcium duhet të jetë në emër të të gjithë pjesëmarrësve të konsorciumit të cilët paraqesin ofertën.

Qëllimi i sigurimit të ofertës është që të garantojë që ofertuesi fitues, brenda 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike pas shpalljes së ofertuesit fitues, sipas përcaktimeve të paragrafit 9.6.1 do të zbatojë marrëveshjen për shitblerjen e aksioneve, thelbësisht sipas formës së draftit në fuqi miratuar nga METE brenda afatit të paraqitjes së ofertave, të sigluar nga Investitori i Interesuar (ose konsorciumi, nëse oferta paraqitet si konsorcium) në ofertën e tij teknike.

Forma dhe përmbajtja e sigurimit të ofertës do të miratohet nga METE, së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.13 Paguesa e tarifës së suksesit nga ofertuesi fitues

Ofertuesi fitues do të ketë detyrimin të paguajë, përveç çmimit të ofruar, një vlerë prej 430,000 (katërqind e tridhjetë mijë) eurosh në llogarinë bankare të *International Finance Corporation* (IFC), si tarifë suksesi e pagueshme për këtë transaksion.

Zotimi i ofertuesit për të paguar tarifën e suksesit do të jetë pjesë e ofertës financiare, për t'u miratuar nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.2 Vlefshmëria e ofertave

6.2.1 Periudha e vlefshmërisë së ofertave

Ofertat do të mbeten të vlefshme për periudhën që vijon afatin për paraqitjen e ofertave, siç detajohet në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat) të miratuara nga METE "Periudha e vlefshmërisë së ofertave". Një ofertë e vlefshme për një periudhë më të shkurtër do të refuzohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave si e papranueshme.



6.2.2 Zgjatjet e afatit

Në rrethana të veçanta, METE mund të kërkojë miratimin e ofertuesve të cilët kanë paraqitur një ofertë, për një zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Kërkesa dhe përgjigjet e tilla duhet të bëhen me shkrim. Nëse ofertuesit pranojnë të zgjasin afatin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, sigurimi i ofertës duhet të zgjatet në përputhje me paragrafin e mësipërm 6.1.12 (dhe ofertuesit do të bëjnë përpjekjet e arsyeshme për këtë qëllim). Një ofertues mund të refuzojë kërkesën e METE-s për zgjatjen e afatit pa humbur sigurimin e tij të ofertës. Një ofertuesi, i cili e pranon kërkesën, nuk do t'i kërkohet dhe as nuk do t'i lejohet që të ndryshojë ofertën e tij.

6.3 Formati dhe nënshkrimi i ofertave

Investitori i Interesuar duhet të përgatisë një ofertë në origjinal dhe me një numër kopjesh sipas përcaktimeve të udhëzimeve për ofertuesit, duke shënuar në mënyrë të dukshme secilën, si origjinale apo si kopja nr. 1 etj. Në raste mospërputhjesh midis origjinalit dhe kopjeve, origjinali do të mbizotërojë.

Oferta në origjinal dhe të gjitha kopjet e ofertës do të nënshkruhen nga Investitori i Interesuar apo nga personi(at) e autorizuar rregullisht për të paraqitur investitorin/konsorciumin. Një autorizim i tillë duhet të dëshmohet nga një prokurë përfaqësimi me shkrim, e paraqitur si pjesë e ofertës teknike, në përputhje me paragrafin 6.1.6. Të gjitha faqet e ofertës, me përjashtim të literaturës së paraprintuar, duhet të nënshkruhet nga personi apo personat të cilët paraqesin këtë ofertë.

7. OFERTAT: PARAQITJA

7.1 Vulosja dhe shënjimi i ofertave

7.1.1 Zarfet e brendshme

Investitori i Interesuar duhet të mbyllë ofertën teknike dhe financiare për shoqërinë objekt, në zarfe të veçantë të vulosura, duke shënuar mbi këto zarfe:

Në një zarf të brendshëm të mbyllur, ku të jenë shënuar fjalët:

i) “OFERTË TEKNIKE - PËR PRIVATIZIMIN E HEC ULËZ SHKOPET SHA”, zarf i cili duhet të përmbajë dokumentet e listuara në paragrafin 6.1.2 që përbëjnë ofertën teknike për – “HEC ULËZ SHKOPET SHA”; dhe

në një zarf të brendshëm të mbyllur, ku të jenë shënuar fjalët:

ii) “OFERTË FINANCIARE – PËR PRIVATIZIMIN E HEC ULËZ SHKOPET SHA”, zarf i cili duhet të përmbajë dokumentet e listuara në paragrafin 6.1.3 që përbëjnë ofertën financiare për – “HEC ULËZ SHKOPET SHA”.

7.1.2 Originali dhe kopjet

Zarfet e brendshme të përshkruara në paragrafin 7.1.1 më sipër, duhet të përgatiten në një origjinal dhe një numër kopjesh siç kërkohet në udhëzimet për ofertuesit. Zarfet që përmbajnë origjinalin dhe secilën kopje të ofertës teknike dhe financiare duhet të futen në zarfe të veçantë, ku të jenë shënuar fjalët:

“OFERTË – PËR PRIVATIZIMIN E HEC ULËZ SHKOPET SHA - ORIGINAL”/ OFERTË - PËR PRIVATIZIMIN E HEC ULËZ SHKOPET SHA – KOPJA NR. 1”;e kështu me radhë;

7.1.3 Zarfet e jashtme

Zarfet e përshkruara në paragrafin 7.1.2 më sipër duhet të vendosen në një zarf të veçantë të jashtëm të mbyllur, ku të shënohet:

“OFERTË – PËR PRIVATIZIMIN E HEC ULËZ SHKOPET SHA”.

Zarfi i jashtëm përshkruar në paragrafin 7.1.3 duhet të mbyllet dhe t’i dërgohet METE-s në adresën e dhënë në udhëzimet për ofertuesit dhe, gjithashtu, duhet të shënohen me fjalët “MOS HAPET PËRPARA DATËS _____.2012, ____:____am/pm, ora e Tiranës”, për t’u plotësuar me afatin e paraqitjes së ofertave siç është përcaktuar më poshtë në paragrafin 7.2 dhe në udhëzimet për ofertuesit.

7.1.4 Identifikimi i ofertuesit

Zarfet e brendshme të përshkruar në paragrafët 7.1.1 dhe 7.1.2 më sipër duhet të kenë të shënuar secili, emrin dhe adresën e Investitorit të Interesuar (ose nëse investitori është një konsorcium, të secilit anëtar të konsorciumit).

Nëse zarfi i jashtëm përshkruar në paragrafin 7.1.3 nuk është i mbyllur dhe i shënuar siç kërkohet më sipër, METE nuk do të mbajë përgjegjësi për ruajtjen e gabuar të zarfit të ofertës apo hapjen gabimisht të zarfit në mënyrë të parakohshme. Nëse zarfi i jashtëm tregon identitetin e ofertuesit, METE nuk garanton anonimitetin e dërgesës së ofertës, por ky identifikim nuk do të përbëjë arsye për refuzimin e ofertës.

7.1.5 Ofertat në mospërputhje



Çdo ofertë që nuk zbaton udhëzimet specifike në paragrafët e mësipërm të paragrafit 7, do të deklarohet në mospërputhje me dokumentet e ofertës dhe do të refuzohet nga komisioni i vlerësimit të ofertës.

7.2 Afati i paraqitjes së ofertave

7.2.1 Afati i paraqitjes së ofertave

Ofertat duhet të merren nga METE-s në adresën e përcaktuar në udhëzimet për ofertuesit jo më vonë se në orën dhe në datën e përcaktuar në udhëzimet për ofertuesit si “Afati i paraqitjes së ofertave”.

7.2.2 Zgjatjet e afatit

METE, në diskrecionin e saj, mund të zgjasë afatin e paraqitjes së ofertave duke ndryshuar udhëzimet për ofertuesit, si dhe duke njoftuar Investitorët e Interesuar në përputhje me paragrafin 5.3, në këtë rast të gjitha të drejtat dhe detyrimet e METE-s dhe Investitorëve të Interesuar do të jenë subjekte të afatit të zgjatur.

7.3 Ofertat e vonuara

Çdo ofertë e marrë nga METE pas afatit të paraqitjes së ofertave do të refuzohet dhe do t'i kthehet e pahapur Investitorit të Interesuar siç është parashikuar në paragrafin 8.6.3.

7.4 Ndryshimet dhe tërheqja e ofertave

Investitori i Interesuar nuk mund të ndryshojë ofertën e tij pas dërgimit të saj.

Investitori i Interesuar që dëshiron të tërheqë ofertën tij duhet të njoftojë më shkrim METE-n, njoftim i cili duhet të merret nga METE përpara afatit për paraqitjen e ofertave. Njoftimi i tërheqjes “Njoftim për tërheqje” duhet t'i dërgohet METE-s në adresën e deklaruar në udhëzimet për ofertuesit, dhe të ketë këtë lëndë:

- RE: “NJOFTIM PËR TËRHEQJE TË OFERTËS – PËR PRIVATIZIMIN E HEC ULËZ SHKOPET SH.A.”

Çdo njoftim për tërheqje i marrë pas afatit për paraqitjen e ofertave do të injorohet dhe oferta e marrë do të konsiderohet e dërguar rregullisht.

Çdo njoftim për tërheqje i marrë në intervalin ndërmjet afatit për paraqitjen e ofertave dhe skadimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës,

përcaktuar në paragrafin 6.2, do të rezultojë në humbjen e sigurimit të ofertës, sipas paragrafit 6.1.12.

8. OFERTAT: HAPJA DHE VLERËSIMI

Procedurat e hapjes dhe vlerësimit të ofertave sipas paragrafit 8 do të jenë publike dhe do të realizohen nga komisioni për vlerësimin e ofertave në datën, orën dhe vendin e treguar në udhëzimet për ofertuesit. Nëse procedurat e hapjes dhe vlerësimit nuk mund të përfundohen brenda të njëjtës ditë, atëherë procesi do të shtyhet dhe rifillohet ditën e ardhshme të punës në të njëjtën orë dhe vend (përveç kur njoftohet ndryshe nga komisioni për vlerësimin e ofertave). Prania e pjesëmarrësve në momentin e hapjes mund të kufizohet për shkak të hapësirës fizike të disponueshme, me kusht që gjithsesi, pjesëmarrja e të paktën dy përfaqësuesve të secilit Investitor të Interesuar që ka dërguar ofertën të jetë e garantuar në çdo rast.

8.1 Hapja e zarfeve të jashtme

Përfaqësuesi(t) e Investitorëve të Interesuar që janë të pranishëm gjatë procedurave të hapjes dhe vlerësimit duhet të nënshkruajnë një regjistër i cili vërteton pjesëmarrjen e tyre.

Asnjë ofertë nuk do të refuzohet në hapjen e zarfeve me përjashtim të ofertave të vonuara në përputhje me paragrafin 7.3.

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të hapë njëkohësisht të gjithë zarfet e jashtme të mbyllur të përshkruar në paragrafin 7.1.3 dhe do të lexojë me zë të lartë, në prani të përfaqësuesit(ve) të Investitorëve të Interesuar, emrin dhe adresën e secilit Investitor të Interesuar që ka paraqitur ofertën, duke përfshirë dhe faktin nëse oferta është marrë brenda afatit për paraqitjen e ofertave në përputhje me udhëzimet për ofertuesit.

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të hapë njëkohësisht të gjitha njoftimet për tërheqje në përputhje me paragrafin 7.4 dhe do të lexojë me zë, në prani të përfaqësuesit(ve) të Investitorëve të Interesuar, emrin dhe adresën e secilit Investitor të Interesuar që ka paraqitur njoftimin për tërheqje, duke përfshirë dhe faktin nëse njoftimi për tërheqje është marrë brenda afatit për paraqitjen e ofertave në përputhje me udhëzimet për ofertuesit.

8.2 Regjistrimi i rezultatit të hapjes

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të regjistrojë:

1. numrin total të ofertave dhe njoftimeve për tërheqje të marra;



2. numrin total të ofertave dhe njoftimeve për tërheqje të marra pas afatit për paraqitjen e ofertave me adresat dhe emrat e Investitorëve të Interesuar përkatës;

3. numrin total të ofertave dhe njoftimeve për tërheqje të marra brenda afatit për paraqitjen e ofertave me adresat dhe emrat e Investitorëve të Interesuar përkatës;

8.3 Hapja dhe vlerësimi i zarfeve të brendshme

Menjëherë pas përfundimit të procedurave të hapjes sipas paragrafit 8.1, në lidhje vetëm me ofertat sipas pikës 3 të paragrafit 8.2 më sipër, në lidhje me të cilat nuk është marrë një njoftim për tërheqje, komisioni i vlerësimit të ofertës do të hapë njëkohësisht:

1. Zarfet e përshkruara në paragrafin 7.1.3 që përmbajnë kopjen origjinale të ofertave; dhe
2. Zarfet e brendshme përkatëse të tyre, të përshkruar në paragrafin 7.1.1(i) që përmbajnë kopjet origjinale të ofertave teknike.

8.4 Ofertat teknike

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të lexojë me zë, në praninë e përfaqësuesit(ve) të Investitorëve të Interesuar, dhe do të regjistrojë përmbajtjen e secilës ofertë teknike të hapur në zbatim të paragrafit 8.3, së bashku me adresat dhe emrat e Investitorit të Interesuar që kanë paraqitur ofertën teknike.

8.5 Ofertat financiare

Komisioni i vlerësimit të ofertave hap në vijim zarfet e brendshme të përshkruara në paragrafin 7.1.1(ii) që përmbajnë ofertat financiare që rezultojnë nga procedura e hapjes sipas paragrafit 8.3.

8.5.1 Çmimi i ofruar

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të lexojë me zë të lartë, në prani të përfaqësuesit(ve) të Investitorëve të Interesuar, shumën e çmimit të ofruar nga secili Investitor i Interesuar dhe do të regjistrojë përmbajtjen e secilës ofertë financiare të hapur sipas këtij paragrafi 8.5, së bashku me adresat dhe emrat e Investitorit të Interesuar që ka paraqitur ofertën financiare.

8.6 Vlerësimi

8.6.1 Kontrolli i përputhshmërisë

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të shqyrtojë dokumentet që gjenden në zarfet e ofertave teknike të hapura sipas paragrafit 8.3 dhe do të përcaktojë nëse janë të plota, thelbësisht e formalisht në përputhje me kërkesat e tenderit, si dhe me udhëzimet për ofertuesit (përfshirë shtojcat).

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të sigurojë veçanërisht që dokumentet e ofertës teknike të përputhen me kërkesat e paragrafit 6.1.2 dhe 6.1.4 deri më 6.1.10, me kërkesat e tjera të këtyre procedurave të tenderit dhe të udhëzimeve për ofertuesin (përfshirë shtojcat). Komisioni për vlerësimin e ofertave do të sigurojë, gjithashtu, që formulimi i draft marrëveshjes për shitblerjen e aksioneve të përputhet me versionin përfundimtar të marrëveshjes për shitblerjen e aksioneve i vënë në dispozicion nga METE përpara afatit për paraqitjen e ofertave.

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të shqyrtojë dokumentet që gjenden në zarfet e ofertave financiare sipas të hapura sipas paragrafit 8.3 dhe do të sigurohet se ato përputhen me të përputhen me kërkesat e paragrafit 6.1.3, 6.1.11 dhe 6.1.12, si dhe me kërkesat e tjera të këtyre procedurave të tenderit dhe të udhëzimeve për ofertuesin (përfshirë shtojcat).

8.6.2 Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i ofertave teknike do të bazohet në kriterin ***kalon ose nuk kalon***, dhe nuk do të kryhet vlerësim me pikë për ofertat teknike.

Ofertat teknike që nuk kalojnë vlerësimin e përputhshmërisë sipas paragrafit 8.6.1 më sipër do të deklarohen si të pavlefshme ose në mospërputhje me dokumentet e ofertës sipas rastit dhe do të skualifikohen nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

Ofertat financiare që gjithashtu kalojnë vlerësimin e përputhshmërisë sipas paragrafit 8.6.1 më sipër do të renditen në bazë të çmimit më të lartë të ofruar.

8.6.3 Kthimi i dokumenteve

Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga dita e përfundimit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave sipas paragrafit 8, komisioni për vlerësimin e ofertave do të njoftojë zyrtarisht me shkrim Investitorët e Interesuar, ofertat e të cilëve janë deklaruar të vonuara, të pavlefshme dhe/ose në mospërputhje me procedurat dhe/ose me udhëzimet për ofertuesit (përfshirë shtojcat), për vendimin përfundimtar për përjashtimin të tyre nga procedurat e mëtejshme të procesit të ofertës.



Së bashku me këto njoftime, komisioni për vlerësimin e ofertave, gjithashtu, do të kthejë zarfet e përshkruara në paragrafët 7.1.1, 7.1.2 dhe 7.1.3, të cilët ishin të pahapura kur oferta u deklarua e tërhequr, e vonuar, e pavlefshme dhe/ose në mospërputhje, sipas rastit.

9. PROCEDURAT E MËTEJSHME

9.1 Pavlefshmëria dhe dështimi i procesit të tenderimit

Komisioni për vlerësimin e ofertave mund të tolerojë gabime materiale, mospërputhje ose parregullsi të vogla në një ofertë, të cilat nuk përbëjnë ndryshim thelbësor dhe që nuk paragjykojnë ose ndikojnë renditjen përkatëse të secilit Investitor të Interesuar si pasojë e vlerësimit të ofertës teknike dhe ofertës financiare.

9.1.1 Oferta të pavlefshme

Përveç rasteve të tjera të parashikuara shprehimisht, një ofertë do të deklarohet e pavlefshme kur:

1. Investitori i Interesuar nuk ka dhënë sigurimin e ofertës, apo siguri i ofertës nuk është në përputhje me kërkesat e këtyre procedurave të tenderit dhe të udhëzimeve për ofertuesin (përfshirë shtojcat);
2. Investitori i Interesuar (apo anëtari i konsorciumit kur oferta paraqitet si konsorcium) ka shkelur konfidencialitetin ose ka dhënë të dhëna të pavërteta në ofertën e tij/saj;
3. Investitori i Interesuar (apo anëtari i konsorciumit kur oferta paraqitet si konsorcium) nuk ka përmbushur ndonjë nga kërkesat e udhëzimeve për ofertuesit dhe dokumente të tjera të ofertës.

9.1.2 Dështimi i procesit të tenderimit

Procesi i tenderimit konsiderohet i pasuksesshëm, e për pasojë i dështuar, nëse:

1. asnjë nga ofertat nuk përmbush kërkesat e udhëzimeve për ofertuesit dhe dokumentet e tjera të ofertës;
2. Këshilli i Ministrave vendos të përfundojë procesin e tenderimit; ose
3. nuk është paraqitur asnjë ofertë.

9.2 Raporti i vlerësimit dhe njoftimi i ofertuesve

Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga data e përfundimit të procedurës sipas paragrafit 8, kryetari i komisionit të vlerësimit të ofertave përgatit një raport përmbljedhës “Raporti i vlerësimit”, i cili përmban:

1. objektin e procesit të tenderimit dhe përqindjen e aksioneve të ofruara për shitje për shoqërinë objekt;
2. një përmbledhje të shkurtër të procedurës dhe të numrit të ofertave të dërguara për shoqërinë objekt;
3. një përmbledhje të ofertave të dërguara për shoqërinë objekt;
4. kriteret kryesore për vlerësimin e ofertave, dhe të vlerësimit të kryer për secilën ofertë për shoqërinë objekt;
5. kriteret e vlerësimit për ofertat financiare; dhe
6. një renditje të ofertuesve sipas çmimit të ofruar për shoqërinë objekt.

Raporti i vlerësimit paraqitet pranë METE-s për t'u dërguar më tej pranë Këshillit të Ministrave së bashku me propozimin e ofertuesit që ka propozuar çmimit të ofruar më të lartë për shoqërinë objekt sipas paragrafit 8.6.2.

9.3 Miratimi/refuzimi nga Këshilli i Ministrave

Këshilli i Ministrave shqyrton raportin e vlerësimit të propozuar nga komisioni për vlerësimin e ofertave dhe me diskrecion të tij:

1. Miraton raportin e vlerësimit dhe ofertën me çmimin e ofruar më të lartë për shoqërinë objekt; ose
2. Miraton raportin e vlerësimit por refuzon ofertën me çmimin e ofruar më të lartë për shoqërinë objekt nëse oferta financiare konsiderohet pa interes ekonomik; ose
3. Refuzon raportin e vlerësimit dhe kërkon korrigjime. Në këtë rast, komisioni i vlerësimit të ofertave bën korrigjimet e nevojshme, dhe raporti i vlerësimit paraqitet përsëri për miratim në përputhje me paragrafin 9.3.

Në vijim të miratimit nga Këshilli i Ministrave sipas pikave (1) më sipër, METE fiton të drejtën për të nënshkruar marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve me ofertuesin fitues, sipas paragrafit 9.5 më poshtë.

9.4 Përfundimi i procesit të tenderimit

Këshilli i Ministrave, në çdo kohë përpara shpalljes së ofertuesve fitues, mund të përfundojë procesin e tenderimit pa i dhënë ofertuesve asnjë argument justifikues.

METE nuk mban asnjë përgjegjësi në ushtrimin e ndonjë të drejte sipas këtij paragrafi.

9.5 Paragrafët përfundimtarë



9.5.1 Njoftimi i ofertuesit fitues

METE, në lidhje me shoqërinë objekt, i dërgon njoftimin e ofertuesit fitues, ofertuesit oferta e të cilit është pranuar nga Këshilli i Ministrave sipas paragrafit 9.3 “Ofertuesi fitues”. Ofertuesi fitues ftohet për ndjekur procedurat vijuese për finalizimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve dhe për nënshkrimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e miratimit të ofertuesit fitues nga Këshilli i Ministrave. Ofertuesi fitues mbetet i detyruar të zbatojë marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, sipas kopjeve të nënshkruara si pjesë e ofertës teknike, pa cenuar të drejtën e METE-s për të vendosur ndryshime të vogla me qëllim qartësimin dhe finalizimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve.

Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit si më sipër, ofertuesi fitues nuk zbaton kërkesat për zgjatjen e afatit të sigurimit të ofertës sipas paragrafit 6.1.11, nëse kjo zgjatje është nevojshme, dhe/ose nuk nënshkruan marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve, METE ka të drejtë të tërheqë sigurimin e ofertës së ofertuesit fitues dhe të ftojë Ofertuesit e tjerë të radhës, që kanë paraqitur një ofertë financiare të vlefshme sipas paragrafit 8.6.2, sipas renditjes së raportit të miratuar të vlerësimit, derisa marrëveshja e shitblerjes së aksioneve të nënshkruhet, ose i propozon Këshillit të Ministrave të përfundojë procesin e tenderimit.

9.6 Kontaktimi me METE-n ose me autoritetet

Duke nisur nga momenti i hapjes së ofertave e deri në momentin e zbatimit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, nëse ndonjë ofertues dëshiron të kontaktojë METE-n, duhet ta bëjë nëpërmjet *e-mail*-it në adresën e përcaktuar në udhëzimin e METE-s, si dhe një kopje të çdo korrespondence dërguar grupit të projektit IFC: albaniahpps@ifc.org.

9.6.1 Finalizimi i marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve

Finalizimi i marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve me ofertuesin fitues do të kryhet me asistencën e International Finance Corporation (IFC).

Me nënshkrimin e marrëveshjes e shitblerjes së aksioneve nga ofertuesi fitues, METE do të njoftojë menjëherë me shkrim, sipas udhëzimeve për ofertuesit (përfshi shtojcat), çdo ofertuesi tjetër që ka dërguar një ofertë financiare të vlefshme sipas paragrafit 8.6.2.

9.7 Kthimi i ofertës dhe konfiskimi

METE do të kthejë sigurimin e ofertës të ofertuesve të pasuksesshëm që kanë paraqitur një ofertë financiare të vlefshme sipas paragrafit 8.6.2, sa

më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas mbarimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës siç është përcaktuar në paragrafin 6.2.1 dhe siç mund të shtyhet në përputhje me paragrafin 6.2.2.

Sigurimi i ofertës i ofertuesit fitues (sipas paragrafit 9.5) do të kthehet me përfundimin e afatit të realizimit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve nënshkruar mes palëve.

Sigurimi i ofertës mund të tërhiqet, me diskrecion të METE-s:

- Nëse ofertuesi (ose çdo anëtar i konsorciumit) bën ndonjë deklaram të pavërtetë material në ofertën e tij;
- Nëse ofertuesi tërheq ofertën gjatë periudhës së vlefshmërisë së ofertës;
- Nëse ofertuesi fitues nuk zbaton kërkesat për zgjatjen e afatit të sigurimit të ofertës sipas paragrafit 6.1.11, nëse kjo zgjatje është nevojshme, dhe/ose nuk nënshkruan marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve në formën e kopjes së nënshkruar, përfshirë në ofertën e tij, në një datë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas shpalljes së ofertuesit fitues sipas paragrafit 9.5.1; ose
- Nëse ofertuesi fitues nuk arrin të realizojë marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në të, për arsye që i atribuohen ofertuesit fitues.

Sigurimi i ofertës bëhet i tërheqshëm me kërkesën e parë të METE-s në rast se verifikohen një apo më shumë nga rrethanat e përshkruara në këtë paragraf.

Konfiskimi i sigurimit të ofertës nuk pengon METE-n që të marrë masa të tjera kundër ofertuesit fitues ose ndonjë ofertuesi tjetër.

Për më tepër, nëse një ofertues ose ofertuesi fitues: i) përdor mashtrimin në marrëdhëniet me METE-n, komisionin për vlerësimin e ofertave, këshilltarët e tij, punëmarrësit, konsulentët ose agjentët në lidhje me projektin; ose ii) provohet se, personalisht apo nëpërmjet një ndërmjetësi, direkt apo indirekt, ka ofruar ose është munduar të ofrojë ryshfet për ndonjë nga punëmarrësit e METE-s të përfshirë në ofertë ose në projekt, atëherë oferta e ofertuesit ose ofertuesit fitues do të anulohet dhe sigurimi i ofertës që do të konfiskohet.

9.8 Konfidencialiteti

METE dhe komisioni për vlerësimin e ofertave do të ruajnë konfidencialitetin e të gjitha të dhënave teknike, ekonomike dhe financiare që rrjedhin nga ofertat. Përveçse nëse parashikohet ndryshe nga ligji, vendimi i gjykatës ose nga udhëzimet për ofertuesin, METE dhe ofertuesit nuk do t'i shpërndajnë asnjë pale të tretë, informacione apo të



dhëna teknike mbi çmimin dhe çdo element tjetër subjekt të diskutimeve, pa lejen e palës tjetër, me përjashtim të këshilltarëve dhe konsulentëve në lidhje me projektin.

9.9 Data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së shitjes së aksioneve

Pas nënshkrimit nga METE dhe nga ofertuesit fitues, marrëveshja e shitjes së 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare “HEC ULËZ SHKOPET” sh.a. miratohet nga Kuvendi, bazuar në propozimin e Këshillit të Ministrave.

VENDIM

Nr. 682, datë 26.9.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SHËNGJIN TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Shëngjin të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Shëngjin, miratuar me vendimin nr. 504, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Shëngjin të qarkut të Lezhës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Shëngjin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Shëngjin

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
12-14	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
17-19	Shërbim funeral	Në pronësi
5-10	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
20,21	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
313,318,324,334,338,339-356	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive) dhe objekte që kanë shërbyer në funksion të bujqësisë	Në pronësi
310, 311, 312, 314, 315, 316, 317, 319, 320	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

VENDIM

Nr. 683, datë 26.9.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 249, DATË 6.3.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS DROPULL I POSHTËM TË QARKUT TË GJIROKASTRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën bashkëlidhur vendimit nr. 249, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohen pronat me nr. 611 (gjashtëqind e njëmbëdhjetë) deri 750 (shtatëqind e pesëdhjetë), gjithsej 140 (njëqind e dyzet) prona, sipas lidhjes nr.1 dhe formularit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Dropull i Poshtëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Komuna Dropull i Poshtëm

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
611-614, 616-617, 621-623, 701-704, 707, 710-711, 713, 715, 718, 720, 722, 749-750	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
615, 618-620, 624-625, 655- 656, 672-676, 678-689, 693- 695, 708-709, 725-727, 729, 736, 737, 739-743, 745-747	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive)	Në pronësi
705, 716-717	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
629-652, 657-663, 666-669, 690-692, 696-697, 712, 723- 724, 728, 730-733, 738, 744	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim

VENDIM

Nr. 684, datë 19.9.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS QELËZ TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qelëz të qarkut të Shkodrës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qelëz të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr. 1177, datë 28.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qelëz të qarkut të Shkodrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qelëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qelëz

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
554	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
555-561	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
562, 563	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
564-575	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
576-585	Varrezat publike	Në pronësi
586-592	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
604-618	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

VENDIM**Nr. 685, datë 3.10.2012****PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN VËNDRESHË TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Vëndreshë të qarkut të Beratit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 35 (tridhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 225 (dyqind e njëzet e pesë).

2. Ndryshimet që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM

Nr. 686, datë 3.10.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË KOMUNËN LESHNJË TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Leshnjë të qarkut të Beratit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 13 (trembëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 213 (dyqind e trembëdhjetë).

2. Ndryshimet që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 687, datë 26.9.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN E STATUSIT TË
ZHVILLUESIT TË ZONËS EKONOMIKE NË ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike” dhe të neneve 4 pika 1 shkronja “g” e 5 pikat 1 e 3 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike në Elbasan është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Sipërfaqet e lira dhe objektet shtetërore që shtrihen në zonën ekonomike Elbasan në administrim të:

- Uzinës 12 dhe Ni-Co;
- Ndërmarrjes së Prodhimit të Çeliqueve;
- Ndërmarrjes së Seleksionimit të Koksit dhe Metaleve;
- Kombinatit Energjetik sh.a.,

të jepen për zhvillimin e zonës ekonomike në Elbasan me çmimin 1 euro.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 1.11.2012
Doli nga shtypi më 2.11.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 72 lekë